



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 71 Akti

Nr. 238 Vendimi
Tiranë, më 17.02.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda	Bekteshi	Kryesuese
Olsi	Komici	Relator
Lulzim	Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në Tiranë, në datën 13.2.2020, ora 13:00 në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Thoma Jano**, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Olsi Komici, dëgjoji shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Thoma Jano, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë Përgjithshme Tiranë dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.1.2018, në përputhje me rregulloren, “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Alma Faskaj dhe Olsi Komici. Relator i çështjes me short u zgjodh komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr.1, datë 22.1.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Thoma Jano, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionere Alma Faskaj. Më pas, me vendimin e Komisionit nr. ***, datë 16.7.2018, është vendosur zëvendësimi i komisioneres Alma Faskaj me komisioneren Brunilda Bekteshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Hans Kijlstra.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 6.2.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Thoma Jano, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 6.2.2020, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë, apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike në datën 12.2.2020.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 13.2.2020, ora 13:00 në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetw, ai parashtrori shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Thoma Jano, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

IV. Z. Thoma Jano ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Thoma Jano, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit u krye për të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Me shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Thoma Jano, i cili është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2003, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa

nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 30.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo aset të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe nga personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmerisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”

1. Apartament banimi me sip. 133 m² në adresën Njësia Administrative Nr. *, Rr. “***”, (***) , p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë blerë në datën 21.9.2000, me vlerë 5,000,000 lekë, me pjesë takuese 34 %.**

Burimi krijimi: blerë me kredi sipas VKM-së nr. 102 datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore” me afat shlyerje 25 vjet.

Nga korrespondenca që Komisioni ka kryer me ZVRPP-në Tiranë¹, kjo e fundit ka konfirmuar se në emër të z. Thoma Jano është regjistruar pasuria e llojit “apartament” me sip. 133 m², me nr. ***, z. k. ***, i ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, hipotekuar në favor të Bankës së Kursimeve, për kredinë në shumën 5,000,000 lekë.

Apartamenti është përfituar me kontratën e shitblerjes², datë 2.9.2000, me shitës shoqërinë “****” sh.p.k., dhe blerës z. Thoma Jano kundrejt çmimit 5,000,000 lekë, çmim ky që do të paguhej nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë e shoqërisë nëpërmjet kredisë që do të merrej në Bankën e Kursimeve.

Nga “Raiffeisen Bank”³ është vënë në dispozicion të Komisionit kontrata e huas⁴ e lidhur në datën 21.9.2000 midis ish-degës së Bankës së Kursimeve Tiranë dhe z. Thoma Jano për shumën 5,000,000 lekë, për blerje banese. Kjo kontratë huaje bazohej edhe në përcaktimet e VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

Apartamenti është hipotekuar në favor të Bankës së Kursimeve me kontratën e hipotekimit të datës 21.9.2000⁵ duke u konfirmuar kështu qëllimi i marrjes së kredisë dhe disbursimi i saj për efekt të blerjes së apartamentit

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore” ka përcaktuar si kriter në pikën 2 të tij që: *“...nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore të mos kenë banesë në momentin që ata përfitojnë kredinë e butë nga shteti dhe më konkretisht: “Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqeje banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti”.*

Komisioni ka konstatuar se subjekti, në momentin e aplikimit për kredinë me kushte lehtësuese nga shteti, nuk ka pasur banesë tjetër në pronësi gjatë ushtrimit të detyrës në Tiranë.

ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar në pronësi të subjektit vetëm pasurinë e paluajtshme “apartament” me të dhënat e mësipërme të blerë me hua nga Banka e Kursimeve me kushte lehtësuese në bazë të VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999.

❖ **Konkluzion**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP Tiranë, nga “Raiffeisen Bank”, si dhe deklarin e subjektit, vlerëson se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin përkatës të administruar nga Komisioni.

Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie vërtetohet se vlera e apartamentit është paguar me kredinë e marrë në ish-Bankën e Kursimeve, bazuar në VKM-në nr. 102, datë 5.3.1999. Kredia me kushte lehtësuese rezulton të jetë përfituar nga subjekti në përputhje me kriteret ligjore përkatëse.

¹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2018, e ZVRPP-së Tiranë, drejtuar Komisionit.

² Kontratë shitblerjeje nr.***, datë 2.9.2000.

³ Shkresë nr. *** prot., datë 6.2.2018, e “Raiffeisen Bank”, drejtuar Komisionit.

⁴ Kontratë huaje nr. ***, datë 21.9.2000.

⁵ Kontrata hipotekimi nr. ***, datë 21.9.2000.

2. Autoveturë tip “Mercedes Benz 210”, me targa *, viti i prodhimit 2000, blerë në datën 10.4.2011, me vlerë 1,800 euro + 409,382 lekë (vlera e doganës), me pjesë takuese 34 %.**

Burimi i krijimit: nuk deklarohet burim krijimi.

Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2011, si vijon: “*Autoveturë Benz, viti 2000, blerë në vlerën 550,000 lekë, me pjesë takuese 33 %*”. Ndërsa në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar: “*Autoveturë tip ‘Mercedes Benz 210’, viti 2000, me vlerë 1,800 euro + 409,382 lekë dogana*”. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

Nga praktika e depozituar nga DPSHTRr-ja⁶, rezulton se këtë automjet, subjekti ia ka blerë një shtetasi gjerman për çmimin 1.800 euro, sipas kontratës së datës 10.4.2011. Vërtetohet se subjekti Thoma Jano ka paguar taksën doganore në vlerën 409,382 lekë sipas dokumentit doganor të datës 19.11.2011. Çmimi total i paguar nga subjekti për këtë automjet rezulton të jetë 1.800 euro x 140.570 lekë (kursi ditor) = 253,026 lekë + 409,382 lekë dogana = 662,408 lekë.

Komisioni ka konstatuar pasaktësi në deklarim për sa i përket çmimit të deklaruar të automjetit “Mercedes Benz”, si dhe mosdeklarim të burimit të krijimit të tij dhe, për këtë arsye i ka kërkuar shpjegime subjektit.

Subjekti ka shpjeguar se⁷: “*... makina kishte të dëmtuara dy parafangot të cilat ishin të dëmtuara nga ndryshku dhe kishin nevojë për riparim e lyerje. Në moment kam biseduar me A.D. dhe ramë dakord që për gomat e disqet si dhe riparimet e parafangove t’i kryeja unë me shpenzimet e mija duke e zbritur çmimin e blerjes në 150.000 lekë. Pas kësaj dakordësie, kam paguar doganën në shumën 409,382 lekë. Është kjo arsyeja pse unë e kam deklaruar çmimin e blerjes së autoveturës në shumën 550.000 lekë, pa dhënë detajet më sipër*”.

Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e autoveturës subjekti ka shpjeguar se ato janë nga pagat e tij dhe të bashkëshortes.

Komisioni ka verifikuar mundësitë financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të, bashkëshortes së tij, për blerjen e këtij automjeti.

Analiza financiare e blerjes së këtij automjeti, duke qenë se nuk është deklaruar burimi i krijimit të tij, është kryer duke marrë në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit deri në momentin e blerjes. Gjithashtu, pavarësisht se në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2011, vlera e këtij automjeti është deklaruar 550,000 lekë, në analizën financiare, vlera e tij është konsideruar, çmimi i blerjes prej 1,800 euro shtuar dhe vlera e zhdoganimit në shumën 409,382 lekë.

Nga analiza financiare e kryer sipas tabelës së mëposhtme për periudhën 1.1.2011 – 31.3.2011 (data e blerjes së makinës), rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, kanë pasur të ardhura të mjaftueshme financiare me burime të ligjshme, për blerjen e kësaj pasurie.

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 6.2.2018, e DPSHTRr-së drejtuar Komisionit; shkresë nr. *** prot., datë 8.2.2018; shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2018.

⁷...Kontrata e shitjes është nënshkruar nga shtetasi gjerman dhe pas mbërritjes në Shqipëri është nënshkruar nga ana ime. Mjeti është sjellë nga Gjermania në Shqipëri nga lidhja miqësore e imja me shtetasin A.D., ish rezident në Gjermani (sot ai nuk jeton më). Në momentin e mbërritjes së autoveturës në Portin e Durrësit, para kryerjes së procedurës së ç’doganimit mjetit makinës i duheshin ndërruar gomat (dimërore dhe të përdorura) dhe disqet e hekurit me disqe alumini, sikundër kishim biseduar më parë...

Përshkrimi	1.1.2011-31.3.2011
Të ardhurat	620,223
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti deri më 31.3.2011	493,707
Nga pagat bashkëshortja e subjektit deri më 31.3.2011	126,516
Shpenzime	179,537
Shpenzime jetese ⁸ deri më 31.3.2011	102,465
Shpenzime për shlyerje kredie deri më 31.3.2011	77,072
Pasuri	658,322
Automjet tip "Mercedes Benz 210", me targa *** ⁹	658,322
Likuiditete	- 313,329
Shtesa/pakësime në likuiditete	-313,329
Të ardhura - shpenzime – pasuri	95,693

❖ **Konkluzion**

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRr-ja, duke marrë në konsideratë edhe faktin se subjekti zotëron burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e mjetit, vlerëson se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin përkatës dhe mosdeklarimi i burimit të krijimit merr vlerën e një pasaktësie pa pasoja në lidhje me rivlerësimin e kriterit të pasurisë

Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit, duke rezultojnë me një balancë financiare pozitive për periudhën e vitit 2011, kur është kryer dhe blerja e kësaj pasurie.

3. Depozitë kursimi në “Credins Bank” në shumën 4,424,352.8 lekë, me pjesë takuese 34 %.

Burimi i krijimit: Nga shitja e apartamentit të përfitur nga privatizimi në qytetin e Ersekës në datën 18.10.1993¹⁰ me vlerë blerje 5,413 lekë dhe shitur me aktin nr. ***, datë 16.8.1994, me vlerë 1,000,000 lekë, që u depozituan në ish-Bankën e Kursimeve kaluar në “Raiffeisen Bank”. Depozita është shtuar me të ardhurat nga pagat dhe interesat bankar.

Subjekti ka depozituar kontratën e privatizimit të banesës në Ersekë të datës 21.8.1993, lidhur ndërmjet tij dhe Ndërmarrjes Komonale Banesa Ersekë për çmimin 5,413 lekë. Ky apartament i është shitur me kontratën e shitblerjes datë 16.08.1994 blerësit Pali Jano, në vlerën 1,000,000 lekë.

“Credins Bank”¹¹ ka konfirmuar llogarinë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në shumën përkatëse.

Referuar deklarimit të subjektit në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite në “Credins Bank” (nga shuma e përfitur nga shitja e shtëpisë në Ersekë), si dhe nga analiza e kryer, rezulton se:

⁸ Shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së, e cila bazohet te INSTAT, duke marrë në konsideratë analizën financiare.

⁹Çmimi i blerjes së mjetit prej 1,800 euro është konvertuar bazuar tek kursi mesatar i Bankës së Shqipërisë për vitin 2011

¹⁰ Kontratë shitjeje nr. *** rep, datë 18.10.1993.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 21.3.2018, e “Credins Bank”, drejtuar Komisionit.

	para deklarimit	2,003	2,004	2,005	2,006	2,007	2,008	2,009	2,010	2,011	2,012	2,013	2,014	2,015	2,016
5 Likuiditete cash ne banese		270,000	500,000	500,000	500,000	650,000	1,150,000	400,000	350,000	450,000	500,000	1,800,000	2,070,000	1,473,666	850,000
6 Gjendje në llogarinë rrjedhëse të subjektit në Credins Bank				1,767,649	6,878	5,950	5,018	4,081	894,032	39,967	322,918	11,898	402,045	205,841	9,308
7 Depozitë e çelur në Credins Bank më 2005					1,760,000	1,870,880	1,971,904	2,096,138	0						
8 Depozitë e çelur në Credins Bank më 2009								700,000	0						
9 Depozitë e çelur në Credins Bank më 2010									3,200,000	3,430,400	3,640,341	3,850,040	4,071,802	4,196,399	4,289,133
10 Gjendje në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes së subjektit në Credins Bank							60,384	89,775	288,379	269,082	353,657	436,412	689,924	740,061	798,830
11 Gjendje në llogarinë rrjedhëse të djalit të subjektit në Credins Bank											123,787	498,686	475,655	382,999	147,759
13 Depozitë e çelur në Credins Bank më 2011 në emër të djalit të subjektit										950,000	1,005,423	1,963,340	3,076,144	3,170,274	0
12 Depozitë në Bankën e Kursimeve subjekti	1,130,000	1,130,000	0												
14 Blerje kuotash në fondin e Investimit "Raiffeisen Prestige"															5,000,000
15 Llogari rrjedhëse subjekti në Raiffeisen Bank				95,383	122,638	243,886	275,832	20,404	23,696	76	1,104	2,933	5,347	8,468	4,171
16 Depozitë në Raiffeisen Bank çelur më 2004			1,300,000	827	793	794	795	0	0						
17 Llogari në Raiffeisen Bank subjekti ***				17,886	17,790	17,435	17,075	16,713	16,351	16,388	18,407	18,448	18,490	18,529	18,568
18 Llogari rrjedhëse bashkëshortja e subjektit në bankën Societe Generale							52,501	52,548	51,395	50,121	48,845	47,569	46,288	44,972	43,456
19 Llogari rrjedhëse bashkëshortja e subjektit në BKT				10,326	111,968	54,335	35	35	0						
20 Llogari rrjedhëse djali i subjektit në BKT														495,464	1,059,718
21 Llogari rrjedhëse djali i subjektit në Union Bank									166,392	32,706	27,729	27,593	26,649	0	
total likuiditete	1,130,000	1,400,000	1,800,000	2,392,072	2,520,068	2,843,281	3,533,544	3,379,694	4,990,244	5,238,739	6,042,211	8,656,919	10,882,343	10,736,673	12,220,943
ndryshim likuiditeti		270,000	400,000	592,072	127,996	323,213	690,263	-153,850	1,610,550	248,495	803,471	2,614,708	2,225,425	-145,670	1,484,270

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga bankat e nivelit të dytë, si dhe deklarimin e subjektit, vlerëson se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin përkatës referuar shumës 1,000,000 lekë përfituar nga shitja e apartamentit në Ersekë që ka shërbyer si burim i krijimit të depozitës në “Credins Bank”¹² për vlerën 4,424,352.8 lekë.

- Kjo depozitë rezulton të jetë çelur në dhjetor të vitit 2005 nga një derdhje prej 400,000 lekësh në datën 13.12.2005 në “Credins Bank” nga subjekti i rivlerësimit dhe një transfertë prej 1,367,490 lekësh nga “Raiffeisen Bank”¹³ në llogarinë e subjektit në “Credins Bank” dhe është shtuar çdo vit me derdhje duke iu shtuar interesi i kapitalizuar dhe gjendja e saj deri në fund të vitit 2016 është në vlerën 4,289,133 lekë¹⁴.
- Nga analiza financiare e pasqyruar më lart, vërtetohet edhe mënyra e krijimit të kësaj depozite kursimi në “Credins Bank” dhe nga Komisioni nuk u konstatuan problematika.

4. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank” me gjendje deri në datën 23.1.2017 në shumën 798.830,52 lekësh, me pjesë takuese 34 %.

“Credins Bank”¹⁵ ka konfirmuar se gjendja e llogarisë rrjedhëse të bashkëshortes së subjektit, znj. N.J.” në “Credins Bank”, në fund të vitit 2016, është në vlerën 798,830 lekë.

Kjo llogari ka qenë fillimisht llogari page e cila në vijim u shtua me të ardhurat nga pensionet e personit të lidhur me subjektin, bashkëshortes së tij.

❖ Konkluzion

Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga “Credins Bank” dhe nuk konstatohen problematika.

5. Gjendje cash nga kursimet, me vlerë 850.000 lekë me pjesë takuese 34 %.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 21.3.2018, e “Credins Bank”, protokolluar me shkresën tonë nr. *** prot., datë 23.3.2018.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 6.2.2018, e “Raiffeisen Bank” protokolluar me shkresën tonë nr. *** prot., datë 8.2.2018.

¹⁴ Depozita në “Credins Bank” është krijuar që në vitin 2005 dhe subjekti e ka pasur këtë depozitë aktive deri në deklaratën “Vetting”.

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2016, e “Credins Bank”.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur analiza financiare, në lidhje me kursimet *cash*, si vijon:

Përshkrimi	2016
Të ardhurat	3,083,206
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti	1,736,952
Të ardhura nga interesat bankare të depozitave	160,122
Nga pagat bashkëshortja e subjektit	265,568
Nga pagat dhe shpërblimet djali i subjekti	920,564
Shpenzime	1,333,277
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	672,828
Shpenzime shkollimi për djalin ¹⁶	90,000
Shpenzime udhëtimi ¹⁷	285,861
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal+interes)	284,588
Pasuri	1,484,270
Kursime (gjendje në fund-gjendje në fillim) ¹⁸	1,484,270
Të ardhura - shpenzime – pasuri	265,659

Në analizën financiare të mësipërme janë marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur me të, shpenzimet dhe pasuritë.

❖ **Konkluzion**

Referuar analizës financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara në fund të vitit 2016, si dhe në deklaratën “Vetting”.

6. Kredi për blerjen e një apartamenti banimi, me sip. 133 m², në adresën: Njësia Administrative Nr. ***, Rr. “****” (***) , p. ***, shk. ***, ap. ***, blerë në datën 21.9.2000, me kredi sipas VKM-së nr. 102, datë 5.3.199, në vlerën 5,000,000 lekë, me afat shlyerje 25 vjet. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer është në vlerën 2,187,451.46 lekë.

“Raiffeisen Bank”¹⁹ ka konfirmuar kredinë e dhënë në emër të z. Thoma Jano, si dhe detyrimin e mbetur pa shlyer bankës.

❖ **Konkluzion**

Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank” dhe nuk konstatohen problematika.

Deklarim i pasurive të personit të lidhur me subjektin, djalit të tij – E.J.

7. Blerje kuotash në fondin e investimit “Raiffeisen Prestigj”, në vlerën prej 5,000,000 lekësh, datë 18.3.2016, nr. llogarie ***, me afat 1-vjeçar.

Burimi i krijimit: nga tërheqja e depozitës në “Credins Bank”, në vlerën 3,413,424 lekë, shtuar edhe me 1,586,576 lekë nga të ardhurat nga pagat dhe pagat e prindërve.

¹⁶ Në përgjigje të pyetësorit të fundit të datës 21.3.2019 subjekti ka deklaruar shpenzime shkollimi për djalin E.J. për masterin në Universitetin “****”, Elbasan, në shumën 90,000 lekë/vit.

¹⁷ Shpenzimet e udhëtimeve janë përlogaritur sipas sistemit *TIMS*, bazuar te vendimi nr. ***, datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit për subjektin e rivlerësimit, E.I.

¹⁸ Në fund të vitit 2015 subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur likuiditete në shumën 10,736,673 lekë (*cash*+bankë) kurse në fund të vitit 2016 kanë pasur likuiditete *cash* në shumën 850,000 lekë dhe likuiditete në bankë në shumën 11,370,943 lekë.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.2.2018, nga “Raiffeisen Bank”.

7.1 Në deklaratën “Vetting” personi i lidhur me subjektin, djali i tij, E.J., ka deklaruar se: “Me kërkesën time në datën 16.1.2017, u hoq nga fondi i investimeve ‘Raiffeisen Prestigj’ shuma 2.900.000 lekë dhe është vënë në dispozicion për blerje letra me vlerë (obligacione) në ‘Raiffeisen Bank’, nr. llog. *** (ankandi datë 3.2.2017)”.

Gjendja në fondin e Investimit “Raiffeisen Prestigj”, në datën 31.1.2017 është në vlerën 2.302.285,69 lekë. Për blerje (obligacione) në “Raiffeisen Bank”, gjendje në vlerën 3.900.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

7.2 Investimi në “Raiffeisen Prestige” e ka prejardhjen nga një depozitë e çelur në vitin 2011 në “Credins Bank” në emër të z. E.J. në shumën fillestare 950,000 lekë dhe gjendja e kësaj depozite deri në fund të vitit 2013 në “Credins Bank” ka qenë në shumën 1,963,340 lekë. Në vitin 2013 është shtuar me shumën prej 900,000 lekësh dhe në vitin 2014 është shtuar me shumën prej 470,000 dhe 530,000 lekësh. Gjendja e kësaj depozite në fund të vitit 2014 ka qenë në vlerën 3,076,145 lekë.

7.3 Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2014 subjekti ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash* në shumën 530,000 lekë dhe shtim në këtë llogari depozite të kësaj shume prej 530,000 lekësh.

Në fund të vitit 2015 gjendja e kësaj llogarie së bashku me interesat është 3,170,274 lekë.

Meqenëse në këtë llogari të djalit të subjektit kanë kontribuar edhe prindërit e tij, analiza financiare është kryer edhe për familjen e tij (prindërit) dhe në tabelën e mëposhtme është reflektuar kronologjia e likuiditeteve *cash* dhe në bankë për të shpjeguar ecurinë e kësaj depozite.

Analiza financiare për periudhën 2011 – 2016

Nr	Pasuri	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Automjet tip Golf-3 ***					-480,000	
2	Automjet tip "Benz" 190 ***	658,322					
3	Ndryshim likuiditetesh	248,495	803,471	2,614,708	2,225,425	-145,670	1,484,270
Total pasuri		906,817	803,471	2,614,708	2,225,425	-625,670	1,484,270
Detyrime							
1	Kredi në Bankën e Kursimeve për blerje shtëpie në shumën 5,000,000 lekë në vitin 2000	-308,289	-284,525	-284,525	-284,587	-284,595	-284,588
Total Detyrime		-308,289	-284,525	-284,525	-284,587	-284,595	-284,588
Vlera Neto e pasurise		1,215,106	1,087,997	2,899,233	2,510,011	-341,076	1,768,858
Te ardhura							
1	Te ardhura nga paga subjekti	1,974,828	1,975,330	1,888,168	1,953,303	1,794,346	1,736,952
2	Të ardhura nga paga bashkëshortja	506,063	615,488	532,756	447,289	318,682	265,588
3	Të ardhura nga paga-i biri i subjektit	0	316,353	848,516	848,516	848,516	920,564
6	Të ardhura nga interesi i depozitave	230,438	320,824	324,572	447,412	378,853	160,122
Totali i te ardhurave		2,711,329	3,227,994	3,594,012	3,696,520	3,340,396	3,083,206
Shpenzime							
1	Shpenzime jetese nga ILDKPIKI sipas INSTAT	409,860	409,860	661,140	661,140	661,140	672,828
2	Shpenzime shkollimi për fëmijët					90,000	90,000
3	Humbje nga shitja e makinës					310,000	
5	Shpenzime te tjera-udhetime nga TIMS	0	0	245,368	45,150	0	285,861
Totali i shpenzimeve		409,860	409,860	906,508	706,290	1,061,140	1,048,689
Total		3,516,574	3,906,131	5,586,738	5,500,241	1,938,181	3,803,376
ANALIZA FINANCIARE		Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
1	Të ardhurat	2,711,329	3,227,994	3,594,012	3,696,520	3,340,396	3,083,206
2	Ndryshimi i pasurise	906,817	803,471	2,614,708	2,225,425	-625,670	1,484,270
3	Shpenzime	409,860	409,860	906,508	706,290	1,061,140	1,048,689
4	Detyrimet	-308,289	-284,525	-284,525	-284,587	-284,595	-284,588
Diferenca per shpenzime		1,086,363	1,730,138	-211,729	480,219	2,620,332	265,659

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi deklaratimet e subjektit, informacionin e vënë në dispozicion nga bankat e nivelit të dytë vlerëson se nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme për blerjen e kuotave në fondin e

Investimit “Raiffeisen Prestigi”, në vlerën 5,000,000 lekë, me afat 1-vjeçar me burim krijimi: (i) depozitën e djalit të subjektit – E.J. në “Credins Bank”; (ii) të ardhurat nga paga e djalit të subjektit; (iii) të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit; dhe (iv) të ardhura të bashkëshortes së tij.

Balanca financiare negative prej – 211,729 lekësh për vitin 2013, është trajtuar në analizën financiare për periudhën 2003 – 2016.

8. Llogari rrjedhëse nga paga në BKT. Gjendje deri më 26.1.2017 në vlerën 115,928.37 lekë, transferuar në “Raiffeisen Bank” në datë 27.1.2017, në dispozicion të blerjes letra me vlerë, në “Raiffeisen Bank” (ankandi datë 3.2.2017). Gjendja më 31.1.2017, në vlerën 115,628.37 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Banka Kombëtare Tregtare²⁰ konfirmon se balanca e llogarisë të personit të lidhur me subjektin, djalit të tij E.J., në datën 19.1.2016 është në shumën 1,115,928 lekë dhe pas transferimit të kësaj shume në “Raiffeisen Bank” në datën 26.1.2017, balanca e kësaj llogarie mbetet në vlerën 115.628,37 lekë.

❖ **Konkluzion**

Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i personit të lidhur me subjektin, djalit të tij E.J., me dokumentacionin e përcjellë nga banka.

9. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”. Me gjendje në datën 23.1.2017, në vlerën 147,759.55 lekë me pjesë takuese 100 %.

“Credins Bank”²¹, konfirmon se gjendja e llogarisë rrjedhëse të shtetasit E.J., në Credins Bank, në datën 23.1.2017, është në shumën 147,759.55 lekë.

❖ **Konkluzion**

Komisioni vlerëson se deklarimi i personit të lidhur me subjektin, djalit të tij – E.J. përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga banka.

KONSTATIME TË TJERA

10. Autoveturë, tip “Volkswagen Golf”, me targa ***, vit prodhimi 1996, i blerë në vitin 2007, në shumën 480,000 lekë dhe shitur në vitin 2015, në shumën 170,000 lekë.

Subjekti këtë mjet e ka deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2007 si vijon: “*blerë automjetin ‘Volkswagen Golf’, me targa ***, në vlerën 480,000 lekë*”. Në deklaratën periodike të vitit 2015 subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në vlerën 170,000 lekë.

DPSHTRr-ja²² ka përcjellë dosjen e këtij mjeti nga ku rezulton se është blerë nga subjekti me kontratën e shitblerjes së datës 7.7.2007²³ nga shitësi I.Gj. me çmimin 250,000 lekë. Në dosjen e mjetit nuk ndodhet i depozituar dokumenti doganor.

Komisioni ka konstatuar mospërputhje për sa i përket deklarimit të çmimit të blerjes së këtij mjeti, pasi në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2007 subjekti ka deklaruar si çmim blerje 480,000

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2018, e BKT-së.

²¹ Shkresë nr. ***prot., datë 21.3.2018, e “Credins Bank”.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2019, e DPSHTRr-së.

²³ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 7.7.2007.

lekë, ndërkohë që sipas kontratës së sipërcituar rezulton se ky mjet është blerë me çmimin 250,000 lekë.

Në lidhje me këtë mospërputhje Komisioni ka administruar procesverbalin e datës 19.1.2016 të përcjellë nga ILDKPKI-ja²⁴ ku subjekti, pasi është thirrur ka shpjeguar se: *“...pas shitjes së automjetit me targa ***, kam blerë autoveturën tip ‘Golf 3’ me targa *** sipas kontratës së datës 7.7.2007, të cilën e kam shitur sipas kontratës së datës 15.12.2015. Mospërputhja e vlerës së kontratës së blerjes me atë të deklaruar nga ana ime, vjen pasi nuk është përfshirë vlera e zhdoganimit...”*

❖ **Konkluzion**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRr-ja dhe ILDKPKI –ja, si dhe deklarin e subjektit, vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me konstatimet në deklarin mbi vlerën totale të deklaruar për automjetin tip “Volkswagen”, me targa ***, duke përfshirë edhe vlerën e zhdoganimit.

11. Automjeti tip “Mercedes-Benz 190” me targa *, i blerë në vitin 2002.**

Ky automjet është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, si vijon: *“Autoveturë tip ‘Benz 190’, prodhim i vitit 1976, me targa ***, me vlerë 300,000 lekë”*.

Komisioni ka konstatuar se ky automjet nuk është deklaruar në vijim nga subjekti në asnjë nga deklaratat periodike të viteve të tjera dhe as në deklaratën “Vetting”.

Nga korrespondenca e kryer me DPSHTRr-në²⁵, është vënë në dispozicion të Komisionit dosja e automjetit me targa ***, ku rezulton se ky mjet është përfituar nga kontrata e shitblerjes së datës 28.9.2002²⁶ me shitës A.R. dhe blerës Thoma Jano, për çmimin 100,000 lekë.

Me kontratën e datës 12.5.2004²⁷, subjekti i rivlerësimit ia ka shitur këtë automjet shtetasit Sh.T. me çmimin 250,000 lekë.

Referuar dokumentacionit dhe procesverbalit të datës 19.1.2016 të mbajtur me subjektin e rivlerësimit në ILDKPKI²⁸ për këtë automjet, subjekti ka deklaruar se: *“Nuk kam arritur të gjej kontratat e shitjes dhe blerjes së këtij mjeti pasi ka ndryshuar pronësia e tij, si dhe nuk është përgjigjur pozitivisht dhe DPSHTRr-ja....”*

Komisioni ka konstatuar pasaktësi në deklarin e vlerës së blerjes së mjetit me targa ***, pasi në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 subjekti ka deklaruar si vlerë blerje çmimin 300,000 lekë, ndërsa kontrata e shitblerjes e datës 22.9.2002 pasqyron çmimin 100,000 lekë.

Gjithashtu, është konstatuar se nuk është deklaruar shitja e këtij automjeti në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2004, pasi referuar kontratës së shitjes së datës 12.5.2004 depozituar nga DPSHTRr-ja, mjeti është shitur në vitin 2004, në vlerën 250,000 lekë.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, si vijon:

²⁴ Shkresë nr. ***, datë 7.12.2018, e ILDKPKI-së.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2019, e DPSHTRr-së.

²⁶ Kontratë nr. ***, datë 28.9.2002.

²⁷ Kontratë shitblerjeje nr. *** datë 12.5.2004.

²⁸ Shkresë nr. ***prot., datë 7.12.2018, e ILDKPKI-së.

a) Në lidhje me pasaktësinë e konstatuar në deklaram lidhur me vlerën e mjetit: *“Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2003, i cili ka qenë edhe deklarimi i parë, kam deklaruar: ‘autoveturë tip ‘Benz 190’, prodhim i vitit 1978, me targa ***, me vlerë 300,000 lekë’. Në vlerën më sipër kam pasur parasysh dhe kam deklaruar në total, veç çmimit të blerjes sipas kontratës, edhe vlerën e doganës në shumën 158.952 lekë, si dhe vlerat e targimit e kontrollit fizik të automjetit. Në këtë deklaratë kam shpjeguar se të ardhurat për blerjen e automjetit burojnë nga të ardhurat familjare pasi kisha shitur më parë një automjet tip Golf 2 me targa ***”.*

b) Në lidhje me mosdeklarimin e shitjes së këtij automjeti në deklaratën periodike të vitit 2004: *“Në periudhën mars 2004 deri tetor 2004 kam qenë me regjim shtrati për 7 (shtatë) muaj pas një ndërhyrjeje kirurgjikale në kolonën vertebrale dhe veprimet për shitjen e këtij automjeti i kanë kryer persona të tjerë të autorizuar verbalisht prej meje. Mospasqyrimi i shitjes së këtij automjeti në deklaratën periodike të pasurisë në vitin 2005 është një pakujdesi (harresë) e imja duke patur parasysh edhe faktin se ishin vitet e para të plotësimit të formularëve të deklarimit të pasurisë dhe nuk ka ekzistuar ndonjë qëllim për fshehjen e saj”.*

❖ **Konkluzion**

Komisioni, pasi analizoi provat e administruara dhe shpjegimet e dhëna, konstaton se shitja e automjetit nga subjekti i rivlerësimit është realizuar në vitin 2004 që vërtetohet me kontratën e shitblerjes së datës 12.5.2004, përcjellë nga DSHPTRr-ja. Në përfundim, Komisioni, vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mosdeklarimin e këtij veprimi dhe se nuk ka dyshime lidhur me të, duke e konsideruar atë pa pasoja në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Nr	Pasuri	para deklarimit	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Apartament banimi me sip.130 m ² (3+1) në vitin 1999 ne Rr.***	5,000,000														
2	Automjet tip "Benz" 190 vit prodhimi 1978, ***	100,000		-100,000												
3	Automjet tip "Benz" 190, ***			400,000			-400,000									
4	Automjet tip Golf-3 ***							480,000							-480,000	
5	Automjet tip "Benz" 190 ***										658,322					
6	Ndryshim likuiditetesh		270,000	400,000	592,072	127,996	323,213	690,263	-153,850	1,610,550	248,495	803,471	2,614,708	2,225,425	-145,670	1,484,270
Total pasuri		5,100,000	270,000	700,000	592,072	127,996	-76,787	1,170,263	-153,850	1,610,550	906,817	803,471	2,614,708	2,225,425	-625,670	1,484,270
Detyrime																
1	Kredi në Bankën e Kursimeve për blerje shtëpie në shumën 5,000,000 lekë	4,360,800	-284,000	-284,400	-284,525	-284,525	-284,563	-284,530	-284,566	-261,067	-308,289	-284,525	-284,525	-284,587	-284,595	-284,588
Total Detyrime		4,360,800	-284,000	-284,400	-284,525	-284,525	-284,563	-284,530	-284,566	-261,067	-308,289	-284,525	-284,525	-284,587	-284,595	-284,588
Vlera Neto e pasurise		739,200	554,000	984,400	876,597	412,522	207,776	1,454,794	130,717	1,871,617	1,215,106	1,087,997	2,899,233	2,510,011	-341,076	1,768,858
Te ardhura																
1	Te ardhura nga paga subjekt	4,759,915	1,132,246	967,487	1,590,315	1,574,230	1,765,532	1,954,199	2,095,843	2,044,168	1,974,828	1,975,330	1,888,168	1,953,303	1,794,346	1,736,952
2	Të ardhura nga paga bashkëshortja		333,795	355,893	345,199	380,476	354,491	441,264	473,589	494,607	506,063	615,488	532,756	447,289	318,682	285,568
3	Të ardhura nga paga-l biri i subjektit									200,000	0	316,353	848,516	848,516	848,516	920,564
4	Të ardhura nga paga-e bija e subjektit			88,320	88,320			225,000								
5	Të ardhura nga paga-e bija e subjektit nga punësimi në Universitetin *** dhe ***				320,453	1,230,070	779,737									
6	Të ardhura nga interesi i depozitave		170,000	72,322	367	110,994	101,098	124,296	168,884	230,438	320,824	324,572	447,412	378,853	160,122	
7	Të ardhura nga shilja e apartamentit në qytetin e Ersekës vitit 1994	994,587														
8	Të ardhura nga shilja e makinës			150,000			80,000									
Totali i te ardhurave		5,754,502	1,466,041	1,731,700	2,416,609	3,185,142	3,090,754	2,721,561	2,693,728	2,907,659	2,711,329	3,227,994	3,594,012	3,696,520	3,340,396	3,083,206
Shpenzime																
1	Shpenzime jetese nga ILDKPIKI sipas INSTAT	2,453,091	438,228	438,228	328,671	328,671	696,288	696,288	522,216	409,860	409,860	409,860	423,072	661,140	661,140	672,828
2	Shpenzime shkollimi për fëmijët	300,713	249,929	114,066	613,125	674,438	149,454								90,000	90,000
3	Humbje nga shilja e makinës														310,000	
4	Shpenzime për makinën e blerë në vitin 2002	200,000														
5	Shpenzime për arredim shtëpie	850,000														
6	Shpenzime te tjera-udhetime nga TIMS			161,109	225,870	218,490	133,407	126,878	58,983	38,867	0	0	175,263	45,150	0	285,861
Totali i shpenzimeve		3,803,804	688,157	713,403	1,167,666	1,221,599	979,149	823,166	581,199	448,727	409,860	409,860	598,335	706,290	1,061,140	1,048,689
Total			1,331,885	2,002,697	2,125,540	2,376,065	2,319,381	3,353,188	2,243,246	4,330,549	3,516,574	3,906,131	5,894,910	5,500,241	1,938,181	3,803,376
ANALIZA FINANCIARE																
	para deklarimit	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	
1	Të ardhurat	5,754,502	1,466,041	1,731,700	2,416,609	3,185,142	3,090,754	2,721,561	2,693,728	2,907,659	2,711,329	3,227,994	3,594,012	3,696,520	3,340,396	3,083,206
2	Ndryshimi i pasurise	5,100,000	270,000	700,000	592,072	127,996	-76,787	1,170,263	-153,850	1,610,550	906,817	803,471	2,614,708	2,225,425	-625,670	1,484,270
3	Shpenzime	3,803,804	688,157	713,403	1,167,666	1,221,599	979,149	823,166	581,199	448,727	409,860	409,860	598,335	706,290	1,061,140	1,048,689
4	Detyrimet	4,360,800	-284,000	-284,400	-284,525	-284,525	-284,563	-284,530	-284,566	-261,067	-308,289	-284,525	-284,525	-284,587	-284,595	-284,588
Diferenca per shpenzime		1,211,498	223,885	33,897	372,346	1,551,021	1,903,830	443,601	1,981,813	587,315	1,086,363	1,730,138	96,444	480,219	2,620,332	265,659

12. Komisioni ka konstatuar se referuar analizës financiare, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultojnë me një mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën - 211,729 lekë, në vitin 2013.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës në lidhje me analizën financiare, ka shpjeguar se disa shpenzime nuk janë reflektuar saktësisht, duke paraqitur edhe dokumente provuese, konkretisht:

- Udhëtim i djalit, në datat 21- 26.1.2013 ka qenë një udhëtim pune për trajnim në shtetin gjerman dhe është financiar tërësisht nga institucioni shtetëror ku punon. Subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentacion ligjor provues për këtë udhëtim dhe kërkoi të zbriten shpenzimet përkatëse.
- Në lidhje me llogaritjen e shpenzimeve jetike sipas të dhënave të INSTAT, duket se në vitin 2013 ka një gabim material pasi konsumi ushqimor për tre familjarë në vitin 2012 reflektohet në vlerën 409,860 lekë, ndërsa për vitin 2013 në vlerën 661,140 lekë. Nëse i referohemi të dhënave të INSTAT për vitin 2013 shpenzimet jetike janë në vlerën 423,072 lekë për tre familjarë. Nëse do të pranohet ky shpjegim duke i llogaritur shpenzimet e jetesës sipas standardit të INSTAT të vitit 2013, do të reflektonte një ulje prej 238,068 lekësh.
- Subjekti ka paraqitur gjithashtu edhe të dhëna mbi disa udhëtime të tjera zyrtare të kryera ndër vite e të paguara nga buxheti i institucionit, megjithëse ato nuk ndikojnë në analizën financiare.

Subjekti i rivlerësimit krahas shpjegimeve ka bashkangjitur edhe dokumentacionin përkatës:

- *Tabela nr. 1, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit.*
- *Një pasqyrë lidhur me udhëtimet e zyrtare jashtë shtetit për periudhën 2008, e në vijim së cilës i bashkëlidhen urdhrat e shërbimit zyrtar dhe përballimi i shpenzimeve nga buxheti i institucionit.*
- *Vërtetim nr. ***, datë 11.2.2020, i SHISH-it lidhur me vizitën zyrtare të djalit E.J.*

Komisioni analizoi dhe mori në shqyrtim shpjegimet e subjektit, si dhe provat e reja të paraqitura prej tij, i mori ato në konsideratë dhe i pasqyroj në analizën financiare²⁹.

Në lidhje me shpenzimet e jetesës, subjekti ka pretenduar se ato duhet të ishin në vlerën 141,024 lekë/person, pretendim i cili është pranuar referuar përgjigjes së ardhur nga ILDKPKI-ja në datën 4.3.2019, lidhur me shpenzimet e jetesës, duke u pasqyruar në analizën financiare.

Analiza financiare e vitit 2013 e rishikuar pas analizimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

VITI	2013
TË ARDHURAT	3,594,012
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti	1,888,168

²⁹Shpenzimi në Korfuz i subjektit dhe bashkëshortes është konsideruar sipas deklaramit të subjektit në shumën 700 euro në korrik të vitit 2013. Subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacion ligjor justifikues për shpenzimet për shkak të detyrës për vete dhe për djalin e tij z. E.J. Për dy prej këtyre udhëtimeve të kryera në vitin 2011 dhe 2012 Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare të viteve respektive, pasi subjekti ka sjellë dokumentacion për këto dy udhëtime. Subjekti paraqiti dokumente të tjera të reja, lidhur me dy udhëtime në vitin 2008 (për një udhëtim pune në Tel-Aviv) dhe një udhëtim në vitin 2010 (Itali), të cilat janë konsideruar në analizën financiare. Subjekti ka dokumentuar një udhëtim të djalit të tij z. E.J. në vitin 2013 (vit në të cilin ai ka qenë i punësuar në SHISH).

Nga pagat bashkëshortja e subjektit	532,756
Nga pagat dhe shpërblimet djali i subjekti	848,516
Të ardhura nga interesat bankare të depozitave	324,572
SHPENZIME	882,860
Shpenzime jetese sipas ILDKPI ³⁰	423,072
Shpenzime udhëtimi	175,263
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal+interes)	284,525
PASURI	2,614,708
Kursime (gjendje në fund-gjendje në fillim)	2,614,708
TËARDHURAT - SHPENZIME – PASURI	96,444

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionin e depozituar prej tij pas kalimit të barrës së provës, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultojnë me një balancë pozitive financiare për vitin 2013 në shumën 96,444 lekë.

⇒ Deklarimi i pasurive të personit të lidhur me subjektin, vajza e tij – E.H. (J.)

E.H. – personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. Thoma Jano, ka bërë deklarin e pasurisë ndër vite dhe në deklaratën “Vetting” në përputhje me pikën 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe është hetuar bazuar në nenet 30 dhe 32/1, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni nuk ka konstatuar deklarime nga vajza e subjektit, znj. E.H. (J.), të ndonjë marrëdhënie interesi pasuror, në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, me subjektin e rivlerësimit apo me persona të lidhur me subjektin dhe, për rrjedhojë, nuk konsiderohet “person tjetër i lidhur” me subjektin e rivlerësimit në kuptim të pikës 14, neni 3, të ligjit 84/2016.

Nga hetimi ka rezultuar se znj. E.H. (J.) është shkëputur ligjërisht nga trugu i familjes së origjinës në datën 29.7.2009³¹, pas martesës me shtetasin E.H. dhe në këtë datë është transferuar në përbërjen familjare me bashkëshortin.

Pasuritë e deklaruara nga vajza e subjektit, znj. E.H. (J.), janë si më poshtë:

1. Apartament banimi me sipërfaqe 142.3 m², me adresë: Rr. “**”, Tiranë, prenotuar nga bashkëshorti me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 20.3.2015, me shoqërinë “****” sh.p.k., në vlerën 80,000 euro.**

- Kësti i parë në shumën 4,900,000 lekë është shlyer nëpërmjet “Credins Bank”, në datën 25.3.2015, nga depozita në emrin e E.H.
- Kësti i dytë në shumën 4,609,600 lekë, paguar në datën 29.12.2015 nëpërmjet llogarisë rrjedhëse në “Credins Bank” në emër të bashkëshortit.

³⁰Referuar shkresës nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së.

³¹ Konfirmuar ky fakt me shkresën nr. prot ***, datë 30.10.2019, nga DPGJC-ja.

- Kësti i tretë, paguar *cash* në shumën 1.128.600 lekë, datë 17.12.2016.

Burimi i krijimit:

(a) Kësti i parë dhe i dytë i pagesës së çmimit të apartamentit, ka si burim financiar të ardhurat dhe kursimet familjare të znj. E.H. dhe të bashkëshortit. Të ardhurat janë pasqyruar të detajuara në rubrikën e të ardhurave ku janë përfshirë ato të dy bashkëshortëve, si dhe të kunatës (motra e bashkëshortit-beqare), e cila jeton me dy bashkëshortët dhe ka qenë në marrëdhënie pune nga viti 2009 e në vazhdim. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një deklaratë sqaruese se të ardhurat janë administruar bashkërisht nga bashkëshorti i vajzës për të mbuluar shpenzimet familjare (bashkëlidhur deklaratë sqaruese). Para martesës bashkëshorti zotëronte *cash* shumën 1.500.000 lekë, nga të ardhurat e tij, të cilat u shpenzuan plotësisht në shlyerjen e kësteve.

(b) Kësti i tretë ka si burim një hua që bashkëshorti i ka marrë shoqërisë “****” sh.p.k.

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Tiranë³², konfirmohet pasuria e llojit “apartament” në emër të z. E.H., me nr. ***, z. k. ***, Tiranë, me sip. 142.30 m² (pasuri aktive).

Ky apartament është përfituar fillimisht me kontratën e sipërmarrjes³³ e lidhur në datën 20.3.2015 me sipërmarrësin shoqërinë “****” sh.p.k., dhe porositës z. E.H. për vlerën 80,000 euro.

Me kontratën e shitblerjes³⁴, datë 28.01.2017 ky apartament i shitet përfundimisht blerësit E.H. për çmimin 11,240,000 lekë (80,000 euro x 140.50 lekë=11,240,000 lekë).

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar dhe dokumentin e datës 27.1.1017 të firmosur nga huadhënësi E.K. dhe huamarrësi E.H. sipas të cilit E.K., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., i ka dhënë shumën 3,000,000 lekë në shkurt 2016 z. E.H., për t’u shlyer për 5 vjet. Huaja është deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2016 nga vajza e subjektit, znj. E.H.

ILDKPKI-ja ka kryer verifikime në lidhje me shtetasin E.K., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., duke kërkuar të dhëna pranë DRT-së Tiranë, Zyrës së Tatim Taksave në Bashkinë Tiranë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

DRT-ja Tiranë³⁵, ka konfirmuar aktivitetin privat të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, regjistruar në emër të shtetasit E.K. (administrator dhe pronar i vetëm).

DRT-ja Tiranë ka paraqitur të dhëna mbi të ardhurat e realizuara dhe fitimin *neto* të kësaj shoqërie, në periudhën 2009 – 2016, sipas viteve përkatëse referuar tabelës së mëposhtme.

Viti	Të ardhura të realizuara	Fitimi <i>neto</i>
2009	3.173.787 lekë	305.978 lekë
2010	7.985.127 lekë	503.386 lekë
2011	14.330.203 lekë	501.218 lekë
2012	14.206.312 lekë	542.634 lekë.
2013	13.980.325 lekë	823.664 lekë
2014	31.640.121 lekë	10.969.837 lekë
2015	25.444.360 lekë	2.930.503 lekë.
2016	25.504.360 lekë	945.949 lekë

³²Shkresë nr. *** prot., datë 19.11.2018, e ZVRPP-së Tiranë, drejtuar Komisionit.

³³ Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 20.3.2015.

³⁴ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.1.2017.

³⁵ Për më tepër shihni në dosjen e ILDKPKI-së, shkresën nr. ***, datë 26.7.2017.

Bashkia Tiranë³⁶ konfirmon se shtetasi E.K. është regjistruar pranë këtij institucioni me aktivitetin tregti me shumicë me NIPT ***, me xhiro 0-2 milionë lekë/vit, për periudhën 2012 e në vazhdim dhe aktivitetin “****” me NIPT ***, me xhiro 0-2 milionë lekë/vit, për vitin 2017.

ISSH-ja³⁷ konfirmon të ardhurat e realizuar nga shtetasi E.K., pranë shoqërisë “****” sh.p.k. (ku për periudhën janar 2012 – shkurt 2016, këto të ardhura rezultojnë në shumën *neto* 4,426,250 lekë) dhe nga E.K. - Person Fizik (ku për periudhën mars 2012 – shkurt 2016, këto të ardhura rezultojnë në shumën *neto* 656,946 lekë).

Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime dhe dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me huan e marrë nga shoqëria “****” sh.p.k., në shumën 3.000.000 lekë me afat shlyerje 5 vjet, pa interes, si dhe të dokumentojë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume nga shoqëria “****” sh.p.k.

Subjekti i rivlerësimit, përveç deklaratës së datë 27.1.2017 të firmosur nga z. E.K., ka depozituar përsëri një deklaratë dore nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., datë 16.11.2018, sipas të cilës z. E.K. deklaroi se: “...deklaroj që në shkurt të vitit 2016 i kam dhënë në formë huaje z. E.H. shumën prej 3,000,000 lekësh me afat shlyerje për një periudhë 5-vjeçare. Ia kam dhënë këtë hua në mirëbesim pa nënshkruar dokument ligjor. Z. E.H. është mjek i punësuar part-time pranë firmës sime. Kompania ime ka të ardhura të justifikuar për këtë hua të vërtetuar me bilanc”, duke bashkëlidhur pasqyrën financiare të subjektit për vitin 2015.

Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.1.2020, me deklarues shtetasit E.H. dhe E.K., ku të dy konfirmojnë dhënien e huas E.H. nga E.K. në muajin shkurt të vitit 2016, në shumën prej 3,000,000 lekësh, me afat kthimi deri në vitin 2021, ku E.K. në deklarinimin e tij shpjegon se “...këtë shumë e ka disponuar cash, nga të ardhura të cilat burojnë nga aktiviteti i shoqërisë ‘***’ sh.p.k.”.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni, konstatohet se shoqëria “****” sh.p.k., ka të ardhura të konsiderueshme që e kalojnë disa herë shumën e huas së dhënë nga z. E.K., (për periudhën 2009 – 2015, rezultoi me fitim neto të deklaruar prej 16,577,220 lekësh). Gjithashtu, rezultoi se nga marrëdhëniet e punësimit të z. E.K. pranë shoqërisë “****” sh.p.k., vetëm për periudhën janar 2012 – shkurt 2016, është përfituar shuma neto 4,426,250 lekë, dhe nga marrëdhëniet e punësimit të tij si person fizik në aktivitetin “****”, për periudhën mars 2012 – shkurt 2016, këto të ardhura rezultojnë në shumën neto 656,946 lekë.

Analiza e tri kësteve të pagesës së shumës totale prej 80,000 euro, të paguara nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. E.J. dhe bashkëshorti për blerjen e apartamentit me sip. 142,3 m², me adresë: Rr. “****”, Tiranë, prenotuar nga bashkëshorti me kontratë sipërmarrjeje, nr. ***, datë 20.3.2015, me shoqërinë “****” sh.p.k.

- a) Kësti i parë në shumën 4.900.000 lekë është shlyer nëpërmjet “Credins Bank”, në datën 25.3.2015, nga depozita e çelur në emrin e vajzës së subjektit të rivlerësimit, znj. E.H., në dhjetor të vitit 2012 në shumën 2,000,000 lekë.

³⁶ Për më tepër shihni në dosjen e ILDKPKI-së, shkresën nr. ***, datë 31.7.2017.

³⁷ Për më tepër shihni në dosjen e ILDKPKI-së, shkresën nr. ***, datë 25.7.2017.

Depozita prej 2,000,000 lekësh ka përshkrimin “transfera nga bankat e tjera” dhe e ka fillesën me një shumë prej 760,000 lekësh, e cila rezulton të jetë transferuar nga llogaria rrjedhëse e pagës e vajzës së subjektit në “Union Bank”. Kjo llogari rrjedhëse në emër të vajzës rezulton të jetë e hapur në datën 16.10.2008 në “Union Bank” (pas martesës), me gjendje fillestare 0 (zero) lekë, ku kalonin pagat e saj nga punëdhënësi, Universiteti “***”. Gjendja e llogarisë rrjedhëse deri në datën 17.12.2012 në “Union Bank” ishte 761,171 lekë dhe nga kjo llogari (llogaria e pagës) në datën 24.12.2012 është transferuar në “Credins Bank” shuma prej 760,000 lekësh. Në datën 26.12.2012 ka dhe një transfertë prej 791,000 lekësh me përshkrimin “transfertë nga bankat e tjera” (pas komunikimit me “Alpha Bank” rezulton se transfera prej 791,000 lekësh është bërë nga llogaria e znj. E.H. në këtë bankë, e cila rezulton të jetë çelur më 11.12.2009 dhe është mbyllur më 26.12.2014). Kjo ka qenë llogari rrjedhëse me gjendje fillestare 0 (zero) lekë, ku janë depozituar në vazhdimësi pagat e znj. E.J. nga punëdhënësi “***” sh.p.k. dhe “Credins Bank” konfirmoi se kjo transfertë është bërë nga llogaria e vajzës së subjektit nga “Alpha Bank”.

Në datën 27.12.2012 ka kryer një derdhje *cash* në këtë llogari në “Credins Bank” në shumën 460,000 lekë, duke krijuar depozitën prej 2,000,000 lekësh. Kjo depozitë e çelur në vitin 2012 është shtuar edhe me 2,000,000 lekë të tjera në vitin 2013 dhe deri në mars të vitit 2015 gjendja e kësaj depozite ishte në vlerën prej 4,963,599 lekësh.

Në datën 25.3.2015 nga “Credins Bank” rezulton se nga kjo llogari depozite janë transferuar në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin “kalim për blerje apartamenti” me kontratë nr. ***, datë 20.3.2015, në shumën 4,900,000 lekë.

- b) Kësti i dytë i paguar nga bashkëshorti nëpërmjet llogarisë së tij rrjedhëse në “Credins Bank”, në shumën 4.609.600 lekë, datë 29.12.2015.

Kësti i dytë i blerjes së apartamentit ka pasur si burim depozitën e çelur në emër të bashkëshortit të vajzës së subjektit në “Credins Bank” në qershor të vitit 2013 në shumën 2,000,000 lekë dhe në gusht të vitit 2014 kjo depozitë së bashku me interesat është mbyllur dhe ka kaluar në një depozitë tjetër në shumën 2,109,800 lekë, e cila është çelur në gusht të vitit 2014 një depozitë në shumën prej 4,500,000 lekësh, duke shtuar edhe shumën prej 2,400,000 lekësh, e cila së bashku me interesat deri në vitin 2015, kur është *maturuar*, ka kaluar në datën 29.12.2015 në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë për blerje shtëpie”, në shumën prej 4,609,600 lekësh nga z. E.H.

- c) Kësti i tretë i paguar *cash* në shumën prej 1.128.600 lekësh, datë 17.12.2016.

Burimi i krijimit, hua ndaj shoqërisë “***”. Komisioni ka shpjeguar më sipër situatën e kësaj huaje.

Të gjitha transaksionet për blerjen e këtij apartamenti, si dhe burimet e përdorura për blerjen e tij nga personi i lidhur, vajza e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshorti, janë realizuar pas martesës dhe pas shkëputjes së saj nga trangu familjar.

Pranë Komisionit është depozituar një denoncim në rrugë elektronike në formën e “informacionit për deklarim të rremë”, në lidhje me një hua të marrë nga shtetasi E.H., dhëndri i subjektit në vitin 2016, nga shoqëria “***” sh.p.k.

Kjo huadhënie është analizuar në mënyrë të hollësishme te pjesa e burimeve të krijimit të të ardhurave, të përdorura për blerjen e apartamentit nga vajza e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

❖ **Konkluzion**

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet, dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i rivlerësimit, dokumentacionin e përcjellë nga institucionet shtetërore, arriti në konkluzionin se:

- Shuma prej 4,900,000 lekësh (kësti i parë i paguar për blerjen e apartamentit, nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, vajza e tij, znj. E.H.), është paguar nëpërmjet “Credins Bank”, në datën 25.3.2015, duke përdorur si burim depozitën në emrin e saj e cila është çelur në dhjetor të vitit 2012, me shumë fillestare prej 2,000,000 lekësh dhe nuk u konstatua ndonjë problematikë në lidhje me pagesën e këtij kësti.
- Shuma prej 4.609.600 lekësh (kësti i dytë i paguar nga llogaria e bashkëshortit të znj. E.H., për blerjen e apartamentit), është paguar nëpërmjet “Credins Bank”, në datën 29.12.2015, duke përdorur si burim depozitën në emër të bashkëshortit, e çelur në qershor të vitit 2013 në emër të z. E.H. me shumë fillestare prej 2,000,000 lekësh dhe nuk u konstatua ndonjë problematikë në lidhje me pagesën e këtij kësti.
- Shuma prej 30,000 euro konfirmohet që është paguar nga huaja e dhënë z. E.H. nga z. E.K., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., nga ku ka rezultuar se z. E.K. qoftë si person fizik, si i punësuar apo edhe si administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., ka të ardhura mëse të mjaftueshme dhe të ligjshme për të dhënë hua këtë shumë.

2. Garazh, i prenotuar nga bashkëshorti E.H. me kontratë sipërmarrjeje nr. *, datë 21.4.2016, me vlerë 1.400.000 lekë (vlera 10,000 euro), me pjesë takuese 50 %.**

Burimi i krijimit: huaja ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Tiranë³⁸, konfirmohet pronësia e llojit “garazh”, me sip. 37.20 m² në emër të z. E.H., me nr. ***, z.k. *** (pasuri aktive).

Me kontratën e sipërmarrjes për prenotim garazhi³⁹ datë 21.4.2016 porositësi E.H. ka porositur te sipërmarrësi shoqëria “****” sh.p.k., dy garazhe kundrejt vlerës 10,000 euro.

Kontrata e shitblerjes e datës 28.1.2017 pasqyron shitjen përfundimtare të garazhit me sip. 37.20 m² nga shitësi “****” sh.p.k., blerësit E.H. për çmimin 1,354,700 lekë (10,000 euro konvertuar me kursin ditor 135,47 lekë/euro).

Burimi i krijimit, i deklaruar nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit është huaja e dhënë nga “****” sh.p.k., që është analizuar më sipër.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit rezulton se pagesa e garazhit për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., është realizuar nëpërmjet një transferte bankare nga llogaria e znj. E.H. te shoqëria, nëpërmjet “Credins Bank”, në datën 26.4.2016, për shumën prej 1,400,000 lekësh.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., 19.11.2018, drejtuar Komisionit.

³⁹ Kontratë sipërmarrjeje për prenotim garazhi nr. ***, datë 21.4.2016.

Llogaria në “Credins Bank” e znj. E.H. është llogari rrjedhëse, llogari në të cilën i kalon paga nga punëdhënësi shoqëria “***” sh.a., paga të cilat përgjithësisht janë lënë gjendje dhe nuk janë tërhequr nga kjo llogari.

Komisioni ka konstatuar, përtej pasaktësisë në deklaram nga vajza e subjektit, se llogaria rrjedhëse e pagës në “Credins Bank” e znj. E.H. ka pasur gjendje të mjaftueshme në datën 26.4.2016, kur është bërë edhe transferta për llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., për të përballuar pagesën prej 1.400.000 lekësh për blerjen e garazhit.

3. Depozitë në “Union Bank” me datë krijimi 24.10.2016, me vlerë 5,500,000 lekë, me pjesë takuese 50 %.

Burimi i krijimit: të ardhura nga punësimi i znj. E.Th.H. dhe bashkëshortit.

“Union Bank”⁴⁰ konfirmon kontratën e depozitës me afat në emër të znj. E.Th.H., llogari e hapur më 24.10.2016, në shumën prej 5,500,000.00 lekësh me interes 1.3 % dhe me rinovim automatik. Rezulton se personi i lidhur me subjektin, vajza e subjektit të rivlerësimit E.H., ka pasur një llogari rrjedhëse në “Union Bank”, e cila është çelur në nëntor të vitit 2008, llogari në të cilën i kalonin pagat nga punëdhënësi Universiteti “***” sh.p.k.

Në këtë llogari, në datën 30.12.2010, znj. E.Th.H. ka depozituar shumën prej 300,000 lekësh *cash* dhe gjendja e kësaj llogarie më 11.1.2011 ka qenë në shumën 698,745 lekë. Në datën 3.2.2011, vajza e subjektit ka depozituar *cash* në këtë llogari shumën prej 301,584 lekësh dhe po në këtë datë ka çelur depozitën me afat në shumën prej 1,000,000 lekësh. Në datë 16.05.2011 gjendja e llogarisë rrjedhëse të vajzës së subjektit është në shumën 790,156 lekë. Në datën 17.5.2011, depoziton *cash* në llogarinë e saj shumën prej 210,000 lekësh dhe çel një tjetër depozitë me afat në shumën 1,000,000 lekë. Në datën 22.9.2011, depoziton *cash* shumën prej 400,000 lekësh, më 7.10.2011 depoziton shumën prej 190,000 lekësh dhe më 9.1.2012 ka depozituar *cash* shumën prej 500,000 lekësh. Gjendja e kësaj llogarie në datën 1.1.2012 ishte në shumën 943,982 lekë dhe më 12.1.2012 çel një depozitë me afat në shumën 1,500,000 lekë.

Nga momenti i parë i çeljes së kësaj llogarie ka pasur depozitime *cash* në këtë llogari, që kanë rezultuar me prejardhje nga burime të ligjshme financiare, si dhe kalime të llogarive nga llogaritë e depozitave në llogaritë rrjedhëse dhe nga llogaritë rrjedhëse në llogaritë e depozitave të vajzës së subjektit të rivlerësimit.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten lidhur me këtë llogari gjendjet e llogarive rrjedhëse dhe të depozitave, si vijon:

Union Bank, vajza e subjektit të rivlerësimit, znj. E.H., sipas viteve	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Llogari rrjedhëse	703,313	943,122	671	2,100	244	5,632,244	85
Llogari depozite		1,000,000	3,500,000	5,000,000	5,500,000		5,500,000
Llogari depozite		1,000,000	1,500,000				

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2018, e “Union Bank”.

❖ **Konkluzion**

Komisioni, pasi analizoi deklarinimin e personit të lidhur me subjektin, vajza e tij, znj. E.H., si dhe dokumentacionin bankar, vlerëson se deklarimi i personit të lidhur me subjektin përputhet me dokumentacionin bankar.

Rezulton e provuar se nga momenti i parë i çeljes së kësaj llogarie ka pasur depozitime *cash* në këtë llogari, të cilat kanë rrjedhur nga burime të ligjshme, si dhe kalime të llogarive nga llogaritë e depozitave në llogaritë rrjedhëse të depozitave të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. E.H., të cilat Komisioni i analizoi më lart.

Nuk konstatohen problematika në lidhje me burimin e ligjshëm të shumave në këtë depozitë.

4. Automjet, tip “Volkswagen”, me targa ***, viti i prodhimit 2000, blerë nga bashkëshorti i znj. E.H. (vajza e subjektit), në datën 11.11.2013, me vlerë 2,000 euro.

Burimi i krijimit: të ardhura nga puna e bashkëshortëve me pjesë takuese 50 %.

Nga korrespondenca e kryer me DPSHTRr-në ⁴¹ për automjetin tip “Volkswagen”, me targa ***, rezulton se është përfituar nga kontrata e shitjes⁴² datë 11.11.2013, me shitës Sh.D. dhe blerës E.H., me çmimin 2,000 euro.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRr-ja konfirmohet se në emër të z. E.H. rezultojnë të regjistruar dhe automjetet e tjera dhe konkretisht:

- automjet, tip “Tiguan”, me targa ***, i blerë në datën 30.10.2017, me çmimin 9,000 euro;
- automjet, tip “Nissan Micra”, me targa ***, i blerë në datën 29.3.2016, me çmimin 3,100 euro.

Komisioni ka konstatuar se automjeti tip “Tiguan”, me targa ***, është blerë në datën 30.10.2017, pra, pas dorëzimit të deklaratës “Vetting” nga subjekti (deklarata “Vetting” është dorëzuar në ILDKPKI, datë 31.1.2017, pra, personi i lidhur me subjektin vajza e tij, znj. E.H., nuk ka pasur detyrimin e deklarinimit të këtij automjeti).

Komisioni ka konstatuar se automjeti tip “Nissan Micra” me targa ***, i blerë me çmimin 3,100 euro, datë 29.3.2016, nuk rezulton të jetë deklaruar nga personi i lidhur me të, vajza E.H., në deklaratën e pasurisë së vitit 2016 dhe në deklaratën “Vetting” dhe për këtë arsye Komisioni, pasi i dërgoi subjektit rezultatet e hetimit, i kërkoi të japë shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar si vijon: *“Autovetura tip ‘Nissan Micra’, me targa ***, është blerë me çmimin 3,100 euro, datë 29.3.2016, në emër të bashkëshortit. Në lidhje me këtë autoveturë vajza E.H. më sqaroi se bashkëshorti dhe nëna e tij ia kishin blerë për dhuratë për ditëlindjen kunatës sime (motra e bashkëshortit), ku bashkëshorti ka kontribuar, në vlerën 1,000 euro. Kjo autoveturë është mbajtur dhe mbahet në përdorim nga kunata pa ndryshuar akoma pronësinë e cila figuron në emër të bashkëshortit E.H. Aktualisht ajo është e martuar dhe nuk bashkëjeton me vajzën. Është kjo arsyeja pse vajza nuk e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2016 dhe në deklaratën Vetting”.*

⁴¹Shkresë nr. ***prot., datë 8.11.2018, drejtuar Komisionit; shkresë nr. *** prot., datë 14.11.2018, drejtuar Komisionit.

⁴² Kontratë shitblerjeje automjeti, nr. ***, datë 11.11.2013.

Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka depozituar edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.2.2020, me deklaratë shtetaset Dh. dhe V.H., të cilat kanë deklaruar të njëjtën situatë të shpjeguar më lart nga subjekti⁴³.

Nga verifikimi i policës së sigurimit në regjistrin e AMF-së, rezultojnë që znj. Dh.H. të jetë regjistruar si përdorues e automjetit për periudhën 1.4.2016 – 31.3.2018.

❖ **Konkluzion:**

Komisioni, pasi analizoi deklaratimet dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti, si dhe dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRr-ja, vlerëson se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRr-ja në lidhje me automjetin tip “Volkswagen” me targa ***, e deklaruar nga personi i lidhur me subjektin, vajza E.H.

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime për automjetin tip “Nissan Micra” në emër të bashkëshortit të vajzës së tij, të cilat Komisioni i konsideroi të mjaftueshme dhe bindëse duke marrë në konsideratë edhe faktin se bashkëshorti i vajzës së subjektit nuk ka qenë subjekt deklarues.

5. Gjendja e likuiditeteve të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, vajzës E.H.

Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me gjendjen e likuiditeteve të vajzës së tij, ka dhënë shpjegime të hollësishme që konsistojnë në të ardhurat nga punësimi i saj, bashkëshortit të vajzës, kunatës së saj, të reflektuara këto në dokumente punësimi dhe bankare, duke qartësuar se:

- *“Të ardhurat gjithsej për E.H. në periudhën tetor 2008 – janar 2017, pasqyruar edhe në deklaratën e plotësuar prej saj si person i lidhur në janar 2017 janë në vlerën **11.887.496** (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.*

*Të ardhurat nga paga e bashkëshortit, si dhe nga paga e bashkëjetueses (kunatës, motra e bashkëshortit), në periudhën 2008 – janar 2017, janë në vlerën **11.704.734** (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) lekë, shumë e cila nuk pasqyron të ardhurat e bashkëshortit të znj. E.H., E.H. përfutur nga punësimi part-time pranë spitalit “***”, pjesë e kompanisë “***” sh.p.k.”.*

Në lidhje me shumën 18,000 USD konstatuar nga llogaria në “Credins Bank” e transferuar nga shoqëria “*” sh.p.k., në llogari të znj. E.H.**

Komisioni konstatoi se nga dokumentacioni i përcjellë nga ILDKPKI-ja, referuar procesverbalit të datës 17.1.2008 të mbajtur me subjektin, ka rezultuar një transfertë bankare nga shoqëria “***” sh.p.k., në llogarinë e znj. E.J. në “Credins Bank”, në shumën prej 18,000 USD. Subjekti, në shpjegimet e tij, ka deklaruar se: *“Kjo transfertë është bërë nga ana e firmës “***” sh.p.k. (kompani ku vajza ka qenë e punësuar), për efekt të marrjes së vizës në Ambasadën Amerikane dhe pas marrjes së vizës, kjo shumë i është rikthyer firmës “***” nga E.H. (J.), në janar 2016...”.*⁴⁴

⁴³Shtetaset Dh. dhe V.H. kanë deklaruar se: *“Unë Dh.H. deklaroj se kam paguar shumën 2,100 euro për të bërë dhuratë një makinë tip “Nissan Micra”, me targa ***, për vajzën time V.H. në vitin 2016 me rastin e ditëlindjes së kësaj të fundit. Unë, V.H., deklaroj se makinën e cituar më lart e kam dhuratë pjesërisht prej nënës sime Dh.H. dhe nga çasti i dhurimit (viti 2016) dhe në vijim këtë makinë e kam përdorur vetëm unë”.*

⁴⁴ Subjekti ka vijuar shpjegimin: *“...ka shpjeguar se në lidhje me llogarinë në USD kredituar me 18,000 USD, datë 12.7.2005, pas mbarimit të universitetit është punësuar tek kompania “***” dhe ambicia për të kryer studime pasuniversitare më bëri të kërkoj të pajisem me vizë 1 vjeçare për në SHBA dhe si kusht kryesor për aplikim kërkohej nga aplikanti një garanci bankare në USD. Për këtë së bashku me babanë tim Thoma Jano kemi diskutuar problemin tim me administratorin e “***”, i cili u tregua i gatshëm të kreditonte në llogarinë time shumën 18,000 USD. Pas pajisjes me vizë, kjo shumë janë tërhequr dhe kthyer sërish administratorit të kompanisë “***”. Për të konfirmuar këtë fakt se përmes një dokumenti nga “***” kemi marrë kontakt me z. P.G. ish-administrator i kësaj kompanie, por mësuam se ai kishte disa vite që kishte pësuar një paralizë dhe aktualisht qëndronte në banesë e larguar nga aktiviteti privat i “***”. Është i gatshëm të deklarojë e të konfirmojë sa më sipër por kjo mund të bëhet e mundur vetëm përmes dërgimit të ndonjë noteri në banesë. Z. P.G. ka në përdorim numrin ***”.*

Komisioni, pasi konstatoi se shuma prej 18,000 USD është tërhequr nga znj. E.H., në dy data të ndryshme, me dërgimin e rezultateve të hetimit i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime më të qarta të shoqëruar me dokumentacion, që konfirmon kthimin e kësaj shume shoqërisë “****”.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se këtë shumë, e cila i nevojitej vajzës E.H. për aplikim vize për në SHBA, ia ka mundësuar shoqëria “****” sh.p.k., ku znj. E.J. ka qenë e punësuar, gjithashtu, subjekti ka deklaruar se kjo shumë i është kthyer po *cash* z. P.G., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.⁴⁵ Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka depozituar: (i) deklaratën noteriale nr. **, datë 8.2.2020, me deklarues z. P.G., i cili ndër të tjera ka konfirmuar faktin se znj. E.J. (H.) ka qenë e punësuar pranë kompanisë farmaceutike “****” për periudhën 2003 – 2005, transfertën nga shoqëria në llogarinë e saj të shumës 18.000 USD, si garanci për marrjen e vizës në Ambasadën Amerikane dhe kthimin e shumës prej 18,000 USD *cash* nga znj. E.J. (H.) dhe se nuk ka pasur asnjë pretendim monetar në të ardhmen; (ii) ka depozituar nxjerrje llogarie nga “Credins Bank” që vërteton kalimin e shumës 18,000 USD nga shoqëria “****” sh.p.k., në llogari të znj. E.H., si dhe tërheqjen e kësaj shume në dy data prej znj. E.J.; (iii) ka depozituar dhe procesverbalin e datës 17.1.2018 të mbajtur në ILDKPKI, ku subjekti ka deklaruar kthimin e kësaj shume nga znj. E.H., shoqërisë “****”.

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacion provues të depozituar dhe shpjegimet e subjektit, i konsideroi të plota dhe bindëse në lidhje me sqarimin e kësaj problematike.

6. Për periudhën 2005 – 2007 vajza e subjektit të rivlerësimit, nga sistemi TIMS, rezulton se ka qëndruar për një periudhë të gjatë kohore jashtë territorit të Shqipërisë

Nga Komisioni iu kërkuan shpjegime subjektit në lidhje me qëndrimin për një kohë të gjatë të vajzës së subjektit jashtë territorit të Shqipërisë, shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe, si dhe me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për të mbuluar këto shpenzime.

Subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për të justifikuar shpenzimet e arsimimit të fëmijëve të tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Subjekti ka shpjeguar se vajza, znj. E.J. (H.), pas përfundimit të kolegjit turk “****” në vitin 1999, vazhdoi studimet në Fakultetin e Farmacisë “****” në Stamboll, Turqi, për katër vite deri në qershor të vitit 2003.

Në periudhën gusht 2003 – korrik 2005, ka qenë e punësuar pranë kompanisë farmaceutike “****”, Tiranë.

⁴⁵Deklarimi i subjektit: “Në periudhën gusht 2003 – korrik 2005, ka qenë e punësuar pranë kompanisë farmaceutike ‘****’ Tiranë, sikurse është deklaruar edhe në deklaratat periodikë të pasurisë. Pas aplikimeve të bëra në gusht 2005 E.J. u pranua të kryejë studimet për master në profilin e administrimit të farmacisë në një universitet në Houston – SHBA në adresën **. Periudha e studimeve zgjati 24 muaj- data e nisjes 5.8.2005. Për marrjen e vizës njëvjeçare për në SHBA, ambasada kishte si kriter pasjen e një depozite bankare në emër të aplikantit në shumën 18.000 USD, të cilën vajza e mësoj në momentin e aplikimit për vizë. Meqenëse ishte periudhë e shkurtër nga aplikimi deri tek nisja e studimeve, vajza kishte biseduar me ish Administratorin e ‘****’, z. P.G. (kompani ku vajza ka qenë e punësuar), i cili i ofroi të bënte një transfertë në këtë shumë dhe e realizoj atë më 12.7.2005 për efekt të marrjes së vizës në Ambasadën Amerikane. Pas marrjes së vizës, kjo shumë i është rikthyer kompanisë ‘****’ sikurse dhe kemi deklaruar më parë. Kjo shumë është tërhequr në *cash* nga E. J. në ditët e para të muajit Gusht 2005 dhe përkatësisht shuma 2,500 USD me datë 2.8.2005 dhe shumat 500 USD dhe 15,000 USD me datë 3.8.2005 dhe po në *cash* i janë dhënë z. P.G. Z. P.G. prej vitësh vuan nga një paralizë dhe u kontaktua në banesë për marrjen e një deklaratë noteriale. Në lidhje me këtë transfertë unë jam thirrur nga specialistë të ILDKPKI-së, datë 17.1.2008, dhe kam dhënë sqarime si më sipër për të cilën është mbajtur edhe një procesverbal, i cili duhet të disponohet edhe nga ILDKPKI-ja, duke e vlerësuar çështje të sqaruar pas kontaktimit nga institucioni përkatës”.

Pas aplikimeve të bëra në gusht të vitit 2005, znj. E.J. u pranua të kryejë studimet për master në profilin e administrimit të farmacisë në një universitet në Houston, SHBA, në adresën: ***. Periudha e studimeve zgjati 24 muaj- data e nisjes 5.8.2005.

Përballimi i shpenzimeve më sipër:

Gjatë periudhës së kryerjes së studimeve, znj. E.J., ka qenë njëkohësisht e punësuar *part-time*, si asistente pedagoge në të njëjtin universitet me kohë katër orë në ditë, kriter i marrëveshjes në momentin e aplikimit, duke përfituar një pagesë mujore 1250 USD në muaj- në total ka përfituar pagesë 24 muaj x 1250 USD/muaj = 30.000 USD, shumë e cila është përdorur për mbulimin e shpenzimeve më sipër.

Znj. E.J. ka përfituar 500 USD nga një fondacion pas një aplikimi të bërë, gjatë periudhës së studimeve.

Përveç sa sipër, znj. E.J., para nisjes në SHBA zotëronte një shumë rreth 3000 USD, të përfituar gjatë kohës së punësimit pranë kompanisë farmaceutike “****”.

Z. E.Th.J. ka kryer shkollën e mesme teknike “****” në Tiranë, në periudhën 2000 – 2005 dhe taksa e paguar për studimet është në vlerën 900 USD në një vit shkollor. Në vitin mësimor 2004, me ndërmjetësimin e drejtorisë së shkollës ka kryer një vizitë në SHBA (periudha 1.6.2004 - 20.8.2004), me një grup nxënësish të kësaj shkolle, pajisur me vizë të tipit J1 (Work and Travel), në funksion të përmirësimit të gjuhës angleze dhe shkëmbimit kulturor ndërmjet të rinjve nga vende të ndryshme të botës. Organizata që organizoi këtë udhëtim dhe qëndrimin në SHBA për rreth dy muaj quhet YMCA (***). Vend i qëndrimit në SHBA – ****:

- ushqimi dhe fjetja përballon nga vendi pritës ku u punësuan për dy muaj;
- në përfundim janë paguar me vlerën 1300 USD për punën e kryer.

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e fëmijëve, që kanë të bëjnë me periudhat e ndryshme të shkollimit, gjithashtu, ka depozituar në seancë dëgjimore, dokumentacionin përkatës në origjinal në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e vajzës, znj. E.J. (H.), gjatë qëndrimit në SHBA.

Të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara dhe të dokumentuara nga subjekti i rivlerësimit janë reflektuar në analizën financiare 2003 – 2016 të kryer nga Komisioni.

7. Llogari rrjedhëse në emër të personit të lidhur me subjektin, vajzës E.H. dhe bashkëshortit të saj, z. E.H.

- llogari rrjedhëse në “Credins Bank”⁴⁶ e vajzës E.H. Gjendja në datën 27.1.2017, në shumën 115,591 lekë, me pjesë takuese 50 %;
- llogari rrjedhëse në “Credins Bank” e shtetasit E.H. Gjendja në datën 18.1.2017, në shumën 65,359 lekë, me pjesë takuese 50 %;
- llogari rrjedhëse në “Credins Bank” e kumatës së vajzës së subjektit të rivlerësimit. Gjendja në datën 30.1.2017, në shumën 30,094 lekë, me pjesë takuese 33 %;
- llogari rrjedhëse në BKT, e kumatës së vajzës së subjektit të rivlerësimit. Gjendja në datën 30.1.2017, në shumën 23,804 lekë, me pjesë takuese 33 %.

⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 5.7.2017, e “Credins Bank”.

Këto llogari janë konfirmuar nga bankat e nivelit të dytë.

❖ **Konkluzion**

Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me deklarinimin e këtyre llogarive bankare dhe gjendjen e tyre.

8. Analiza financiare e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. E.H. dhe familjes së saj për vitet 2008 – 2016

Nga informacioni i administruar nga deklaratat e pasurisë, gjatë hetimit administrativ nga bankat e nivelit të dytë, si dhe nga shpjegimet e dhëna janë pasqyruar likuiditetet e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. E.H. dhe familjes së saj për periudhën 2008 –2016.

Për të ardhurat e vajzës së subjektit të rivlerësimit i jemi referuar të dhënave nga bankat e nivelit të dytë, duke analizuar kreditimet e llogarisë së vajzës së subjektit të rivlerësimit, për derdhjet e pagave në llogaritë e saj, kryesisht në bankat: BKT, “Credins Bank” dhe “Union Bank”.

Të ardhurat e bashkëshortit të vajzës së subjektit të rivlerësimit janë marrë referuar të dhënave nga bankat e nivelit të dytë, duke analizuar kreditimet e llogarisë së bashkëshortit të vajzës së subjektit të rivlerësimit, për derdhjet e pagave në llogaritë e tij, kryesisht, në “Credins Bank” dhe “Raiffeisen Bank”. Gjithashtu, të ardhurat e vajzës së subjektit dhe të bashkëshortit janë përfshirë edhe të ardhurat nga interesi i depozitave në bankat e nivelit të dytë.

Të ardhurat e motrës së bashkëshortit të vajzës së subjektit janë administruar gjatë hetimit administrativ, në dosjen e ILDKPKI-së nga bankat e nivelit të dytë, kryesisht nga “Credins Bank” dhe nga BKT-ja.

Lidhur me shpenzimet janë konsideruar shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së (e cila bazohet tek INSTAT-i) për vajzën e subjektit dhe familjen e saj, duke marrë në konsideratë përbërjen e saj familjare, sipas certifikatës së depozituar prej subjektit, si dhe duke konsideruar deklarinimin e vajzës së subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, ku ka deklaruar se bashkë me ta ka jetuar edhe motra e bashkëshortit të saj që prej vitit 2009, gjatë hetimit administrativ ku rezultoi se në vitin 2008 familja e saj ka qenë e përbërë nga dy anëtarë, për periudhën 2009 – 2010 ka qenë me katër anëtarë dhe për periudhën 2011 e në vijim ka qenë me pesë anëtarë.

Shpenzimet e udhëtimeve për vajzën e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj, të rezultuara nga sistemi *TIMS*, janë përfshirë në analizën financiare nga momenti i lidhjes së martesës (shtator 2008, e në vijim) dhe janë përllogaritur bazuar në standardin e vendosur nga Kolegji i Posaqëm i Apelit.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet analiza financiare e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. E.H. dhe familjes së saj, nga viti 2008 (viti i shkëputjes së saj nga trangu familjar) deri në fund të vitit 2015, kur janë bërë pagesat e dy kësteve të apartamentit të blerë prej tyre në vitin 2015. Janë përfshirë në këtë analizë financiare të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, likuiditetet, të ardhurat, shpenzimet e jetesës për familjen e vajzës së subjektit.

Periudha	2008 - 2015
Apartament banimi me sip. 142.3 m ² , Rr. "****", Tiranë	9,509,600
Automjet tip "Volkswagen", blerë në vitin 2013, vlera 2.000 euro ⁴⁷	280,420
Shtesa në likuiditete	5,226,395
Total Pasuri	15,016,415
Të ardhura nga paga e vajzës së subjektit	10,204,755
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të vajzës së subjektit	5,083,527
Të ardhura nga interesat bankare	1,006,854
Të ardhura nga paga e motrës së bashkëshortit të vajzës së subjektit	4,291,517
Të ardhura nga shitja e automjetit tip "Benz", me targa **** ⁴⁸	275,300
Total të ardhura	20,861,953
Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare	6,262,812
Shpenzime udhëtime nga sistemi TMS ⁴⁹	300,086
Total Shpenzime	6,562,898
Diferenca (të ardhura-shpenzime-pasuri)	-717,360

Në analizën financiare për familjen e znj. E.H., është përdorur metodologjia kumulative, pasi bashkëshorti dhe kunata (anëtarë të familjes) nuk janë subjekte deklaruese.

Subjektit i kaloi barra e provës për të shpjeguar lidhur me rezultatin financiar negativ, të rezultuar nga analiza financiare për vitet 2008 – 2015.

Në vlerësim të të ardhurave, shpenzimeve dhe likuiditeteve në bankë, gjatë viteve kalendarike u evidentuan diferenca në vitet 2011 – 2014, për të cilat iu kërkuan subjektit të rivlerësimit të shpjegonte lidhur me burimin e tyre.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti dha sqarime lidhur me gjendjen e likuiditeteve të personit të lidhur me të dhe familjarëve të tij dhe përdorimin e tyre ndër vite, si më poshtë.

Subjekti ka kërkuar që të reflektohet korrigjimi përkatës në shpenzimet jetike për vitin 2013, pasi kanë të njëjtin gabim material në llogaritje, si dhe tek analiza e subjektit të rivlerësimit të arsyetuar më sipër.

Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ndër të tjera, dha shpjegime, si vijon:

“Referuar analizës financiare të paraqitur nga Komisioni për vajzën time E.H., në cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj, unë dua së pari të sqaroj Komisionin se vajza ime është në profesion farmacistë dhe bashkëshorti i saj mjek kirurg obstetërgjinekolog. Të dy janë martuar dhe jetojnë së bashku, që prej vitit 2008 dhe nuk kanë asnjë marrëdhënie financiare apo interesi me mua apo bashkëshorten time. Ajo që më kanë shpjeguar pasi ju kam vënë në dispozicion rezultatet e analizës financiare të Komisionit ka qenë se ata prej vitesh kanë bërë përpjekje për të shkuar, për të jetuar e punuar në Gjermani, me kontrata pune

⁴⁷ Konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2013.

⁴⁸ E shitur në vitin 2015 në shumën 2,000 euro, e konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2015.

⁴⁹ Përlllogarit sipas vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit për subjektin E.I.

sipas profesionit që kanë. Këto përpjekje nuk u realizuan, ndaj edhe në vitin 2015 ata vendosën të blejnë këtë apartament, duke shfrytëzuar të gjitha të ardhurat dhe kursimet e tyre cash ndër vite. Kështu, ata më kanë treguar se në vitet 2012 – 2013 – 2014 kanë transferuar në llogaritë e tyre bankare, gradualisht, pjesë të kursimeve cash që kanë pasur në shtëpi, si dhe të ardhurat që ata marrin nga pagat nga puna e tyre, si dhe honorarë të ndryshëm. Më kanë shpjeguar se shuma prej 1.500.000 lekësh, e kursimeve cash, që ata kanë disponuar që në vitin 2008 (kursime të bashkëshortit E.H. nga puna, si mjet që prej vitit 2002 – 2008) është derdhur në bankë në vitin 2013. Po ashtu, për shumatat e kursimeve të mbledhura ndër vite (2008 deri në vitin 2012,) ata kanë realizuar derdhje në bankë në vitet në vijim. Në analizën e Komisionit kursimet cash janë mbartur deri në vitin 2015, kur është blerë shtëpia, por në fakt siç ata më kanë shpjeguar, shtëpinë ata e kanë blerë me transfertë bankare dhe kursimet cash janë derdhur në bankë kohë më parë. Në vitin 2009, sipas tabelës së likuiditeteve të Komisionit ata kanë 1.500.000 lekë kursime cash, të mbartura nga viti 2008 dhe mundësia për kursim në vlerën 264.279 lekë. Në total, likuiditete në fund të vitit 2009 – 1.764.276 lekë.

Në fund të vitit 2010, mundësia për të shtuar kursimet ka qenë me 2.004.698 lekë dhe likuiditete në fund të vitit 2010 – 3.768.974 lekë.

Këto kursime janë mbartur në vitin 2011 dhe një pjesë e tyre kanë mbuluar diferencën mes të ardhurave dhe shpenzimeve (përfshirë këtu likuiditete në bankë) të vitit, duke rezultuar në fund të vitit kursime cash, në shumën 3.377.438 lekë.

Kursimet cash janë mbartur në vitin 2012, ku një pjesë e tyre kanë mbuluar diferencën mes të ardhurave dhe shpenzimeve (përfshirë këtu likuiditete në bankë) të vitit, duke rezultuar në fund të vitit kursime cash në shumën 2.309.223 lekë.

Në vitin 2013, të gjitha kursimet cash në masën 2.309.223 lekë, janë derdhur në bankë, shuma këto që kanë rezultuar edhe nga analiza juaj të derdhura cash më tepër se të ardhurat e vitit.

Vajza më ka deklaruar se bashkëshorti i saj, i cili ka punuar si mjek kirurg obstetër-gjinekolog, ka punuar edhe punë part-time, në klinikën ‘***’, që prej vitit 2010 deri aktualisht. Vetëm prej fillimit të vitit 2014, ai është i deklaruar dhe siguruar me numër sigurimesh *** nga administratori i këtij spitali privat, me pagesë mujore 24.000 lekë në muaj, të deklaruar pranë organeve tatimore (vërtetimi i administratorit është dërguar bashkëlidhur deklaratës ‘Vetting’ janar 2017).

Gjithashtu, vajza më ka thënë se bashkëshorti ka kryer vizita/operacione/mjekime gjinekologjike edhe para vitit 2014 (që nga viti 2010), veprime të cilat ekzistojnë të pasqyruara edhe në emër të tij si mjek sekondar edhe në kartelat përkatëse mjekësore të kësaj klinike, por ata nuk mund të provojnë të ardhurat e sakta nga kjo veprimtari para vitit 2014. Kartelat mjekësore, gjithashtu, nuk mund të bëhen publike për shkak të privatësisë që mbartin (bashkëlidhur kopje e noterizuar e ‘Licensë për ushtrimin individual të profesionit për mjekë’, lëshuar nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë për z. E.H., bashkëshort i znj. E.H., rinovuar në datën 1.3.2017).

Prej vitit 2014 e në vijim, bashkëshorti i vajzës, z. E.H., vazhdon të ketë marrëdhënie me klinikën ‘***’ me të ardhura të deklaruara në shumën 24.000 lekë në muaj, të cilat nuk janë reflektuar në analizën financiare të Komisionit, të cilat përmirësojnë gjithashtu efektin financiar negativ të analizës suaj. Mbase mungesa e pasqyrimin të tyre në analizën financiare të Komisionit ka ardhur për shkak se ato të ardhura janë marrë cash dhe jo nëpërmjet llogarive bankare.

Të gjitha shpjegimet më lart i përkasin analizës së detajuar vjetore të paraqitur prej Komisionit dhe konsiston në paraqitjen me transparencë të shpjegimeve, lidhur me shumat e derdhura cash nga vajza dhe bashkëshorti i saj, në llogaritë bankare të evidentuara nga Komisioni.

Në referim të analizës financiare kumulative, të paraqitur nga Komisioni, në total për vitet 2008 – 2015, efekti negativ financiar rezulton në masën -717.361. Kjo analizë në vlerësimin tim pasqyron situatën reale të shpjeguar nga unë dhe ka logjikë financiare, sepse të ardhurat e mbartura çdo vit nga ekonomia familjare e tyre janë kursyer nga ata vetë dhe në momentin kur kanë vendosur të blejnë shtëpi dhe mos emigrojnë në Gjermani janë derdhur përkatësisht në banka, sipas interesave të tyre.

*Edhe vlera negative prej 717.361 lekësh, reflekton të ardhura të pallogaritura të dhëndrit nga puna e tij si mjek kirurg obstetër-gjinekolog, në klinikën ‘***’, të cilat nëse llogariten vetëm për vitet 2014 – 2015, si dhe diferenca e shpenzimeve jetike, të llogaritura gabimisht për vitin 2013 për pesë persona. Nëse këto shpjegime do të pranohen nga Komisioni, rezultati financiar ndryshon”.*

Komisioni analizoi të gjitha shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti, lidhur me rezultatet e hetimit dhe i konsideroi të mjaftueshme, duke i marrë në konsideratë në analizën financiare të Komisionit, e cila rezultoi si vijon:

❖ **Konkluzion**

Subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti i vajzës ka pasur të ardhura nga dypunësimi në shumën 24.000 lekë në muaj duke paraqitur dokumentacion nga punëdhënësi ku specifikohet dhe numri përkatës i sigurimeve shoqërore. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit qëndrojnë. Ai ka llogaritur vlerën neto të tyre, e cila shkon në masën 312,576 lekë, duke i përfshirë këto të ardhura në analizën financiare. Po ashtu edhe pretendimi mbi gabimin material në llogaritjen e shpenzimeve jetike, duke iu referuar gabimisht shpenzimit jetik për frymë të vitit pasardhës, është i drejtë dhe i bazuar në shkresën e ILDKPKI, referuar standardit të përcjellë nga INSTAT, duke zbritur vlerën prej 396,780 lekë nga analiza financiare e kryer.

Komisioni, referuar shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të dërguar pas rezultateve të hetimit, si dhe të dhënave të administruara, vlerëson se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. E.H. dhe personat e lidhur me të, kanë pasur mungesë të burimeve financiare në vlerën - 8,004 lekë, duke e vlerësuar atë si të papërfillshme.

Komisioni vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me gjëndjet e të ardhurave, shpenzimeve dhe likuiditeteve në bankë, gjatë viteve kalendarike 2011 – 2014, dhe i gjen ato të plota dhe bindëse.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se vajza e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë patur të ardhura të ligjshme për të përballuar shpenzimet dhe për të krijuar pasuritë e deklaruara përgjatë periudhës 2008-2016.

9. Analiza financiare për vajzën e subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, deri në vitin 2016, kur është kryer pagesa e këstit të tretë për blerjen e apartamentit, si dhe pagesa për blerjen e garazhit.

Viti	2008 - 2016
Apartament banimi me sip. 142.3 m ² , Rr. "****", Tiranë	10,638,200
Garazh i prentuar dhe shlyer në vitin 2016	1,400,000
Automjet tip "Volkswagen", blerë në vitin 2013, vlera 2.000 euro ⁵⁰	280,420
Automjet tip "Nissan Micra", blerë në datën 29.3.2016, vlera 3.100 euro ⁵¹	419,337
Shtesa në likuiditete	4,167,854
Total Pasuri	16,905,811
Hua marrë shoqërisë "****" për blerje shtëpie	3,000,000
Total Detyrime	3,000,000
Të ardhura nga paga e vajzës së subjektit	11,099,114
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të vajzës së subjektit	5,854,853
Të ardhura nga interesat bankare	1015311
Të ardhura nga paga e motrës së bashkëshortit të vajzës së subjektit	5077465
Të ardhura nga shitja e automjetit tip "Benz", me targa *** ⁵²	275,300
Total të ardhura	23,322,042
Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare	6,987,412
Shpenzime udhëtime nga sistemi TIMS ⁵³	304,820
Total Shpenzime	7,292,232
Diferenca (të ardhura+detyrime-shpenzime-pasuri)	2,123,998

❖ Konkluzion

Komisioni vlerëson se nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, personi i lidhur me subjektin, vajza E.H. dhe personat e lidhur me të, kanë pasur burimeve të ligjshme, të mjaftueshme financiare për të shlyer këstin e fundit të apartamentit dhe garazhin, si dhe për të përballuar shpenzimet përgjatë periudhës 2008 – 2016.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke analizuar rezultatet e konstatuara nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit si dhe i personave të tjerë të lidhur me të, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur me të rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

V. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z.

⁵⁰Konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2013.

⁵¹ E blerë në vitin 2016, në shumën 3,100 euro, e konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2016.

⁵²E shitur në vitin 2015, në shumën 2,000 euro, e konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2015.

⁵³Përlllogarit sipas vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për subjektin E.I.

Thoma M. Jano, i deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. *** datë 20.2.2018 dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se:

“Për subjektin e rivlerësimit, z. Thoma M. Jano, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Nga hetimi administrativ, i kryer nga Komisioni, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si prokuror.

❖ **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, z. Thoma Jano, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

VI. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Rivlerësimi profesional, bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 84/2016 është i bazuar në raportin e Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i cili ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 10.4.2018 për subjektin e rivlerësimit, z. Thoma Jano.

Në raportin e Grupit të Punës, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, janë evidentuar aftësi të mira të subjektit të rivlerësimit në lidhje me:

- ✓ *aftësitë organizative;*
- ✓ *etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;*
- ✓ *aftësitë personale dhe angazhimi profesional.*

Komisioni ka analizuar formularin e vetëdeklarimit, tri dosjet e zgjedhura nga vetë subjekti, pesë dosjet e shortuara nga Komisioni, si dhe të dhënat nga burimet arkivore dhe të strukturave të tjera të Prokurorisë së Përgjithshme.

➤ **Formulari i vetëdeklarimit**

Rezulton se formulari është i plotësuar sipas udhëzimit të shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

➤ **Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

1. Dokumenti “sekret”, nr. *** prot., datë *****, “kthim përgjigje”, adresuar Kuvendit, Komisionit të Sigurisë Kombëtare, kryetarit, z. S.B., në përgjigje të kërkesave të Kuvendit nr. ***, në datat ***** dhe *****.

Grupi i Punës ka hetuar dhe konstatuar, si më poshtë:

Kryetari i Komisionit për Sigurinë Kombëtare, me shkresën përcjellëse datë 25.6.2014, ka njoftuar Prokurorin e Përgjithshëm për realizimin e një kontrolli në Shërbimin Informativ të Shtetit, me synim kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë dhe të akteve nënligjore, që normojnë aktivitetin e Shërbimit Informativ të Shtetit në kryerjen e procesit të përgjimit parandalues, që bazohet në ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003, “Për përgjimin e komunikimeve elektronike” (i ndryshuar).

Me këtë njoftim i kërkohet Prokurorit të Përgjithshëm dhënia e autorizimit për një grup deputetësh të Komisionit të Sigurisë Kombëtare në Kuvendin e Shqipërisë, për të ushtruar kontroll në strukturën përgjegjëse të përgjimeve në SHISH, por Prokurori i Përgjithshëm ka kthyer përgjigje se nuk ka kompetencën ligjore të autorizojë ushtrimin e kontrollit në strukturën përgjegjëse të përgjimit në SHISH.

Subjekti i rivlerësimit, z. Thoma Jano, ka përpiluar dokumentin “kthim përgjigje”, i cili i është dërguar Komisionit të Sigurisë Kombëtare me nr. *** prot., datë *****, duke sqaruar dhe interpretuar të gjithë situatën, ashtu siç parashikohet në ligj.

Duke referuar dhe pasqyruar në akt, bazën ligjore ku mbështet kjo veprimtari, ka konkluduar se duke iu referuar dispozitave të ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003, “Për përgjimin e komunikimeve elektronike” (i ndryshuar), Prokurori i Përgjithshëm nuk ka autoritetin ligjor të autorizojë ushtrimin e kontrollit në strukturën përgjegjëse të përgjimit në SHISH.

2. Dokumenti nr. ***, datë *****, “dhënie mendimi për projektligjin për Policinë e Shtetit”; dokumenti “sekret” nr. ***, datë *****, “mbi udhëzimet e përbashkëta” të Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, nr. ***, datë *****, “për dhënie mendimi” për Drejtorinë e Studimeve, Kërkimit dhe Integritit.

Grupi i Punës ka hetuar dhe konstatuar, si më poshtë:

Dokumentet e sipërcituara janë përpiluar në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe trajtojnë problemet ligjore të konstatuara në projektligjin “Për policinë e shtetit” dhe udhëzimet e përbashkëta që duhet të dilnin pas miratimit të këtij projektligji, të cilat janë dërguar për mendim, nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Në datën 31.7.2014 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 108/2015, “Për Policinë e Shtetit”. Para miratimit nga Kuvendi, projektligji “Për Policinë e Shtetit” i është dërguar Prokurorit të Përgjithshëm për mendim. Për këtë qëllim, në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur dhe krijuar një Grup Pune, në të cilin ka marrë pjesë edhe subjekti i vlerësimit, z. Thoma Jano.

Në përfundim të shqyrtimit të projektligjit, Grupi i Punës ka përgatitur dokumentin e titulluar “dhënie mendimi për projektligjin për Policinë e Shtetit”, i cili i është dërguar me shkresën nr. ***, datë *****, ministrit të Punëve të Brendshme dhe për dijeni Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend.

Pas studimit të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, subjekti i rivlerësimit, z. Thoma Jano ka hartuar përgjigjen me nr. ***, datë *****, “mbi udhëzimet e përbashkëta”, dërguar në adresë të ministrit të Punëve të Brendshme dhe për dijeni Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

3. Dokumenti “sekret” nr. ***, datë ***** “kthim përgjigje” z. G.B., *** dhe për dijeni Zyrës së Delegacionit European në Shqipëri, nr. ***, datë *****, “dhënie mendimi për një projektligj”, drejtuar ministrit të Drejtësisë, z. N.N., nr. ***, datë *****, “kërkesë për ushtrimin e iniciativës ligjore”, drejtuar ministres së Shtetit dhe Inovacionit dhe Administratës, znj. M.H., dhe për dijeni ministrit të Brendshëm, z. S.T., ministrit të Drejtësisë z. N.N.

Grupi i Punës ka hetuar dhe konstatuar, si më poshtë:

Dokumentet e mësipërme janë përpiluar në kuadër të diskutimeve të ndryshimeve që do t'i bëheshin Kodit të Procedurës Penale në kuadër të reformës në drejtësi dhe ligjit nr. 9157/2003, “Për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike” (i ndryshuar). Në përgatitjen e këtyre dokumenteve, subjekti vlerësimi, z. Thoma Jano, ka punuar vetëm dhe në grup pune.

Në këtë dokument, subjekti Thoma Jano, pasi informon institucionet e mësipërme për mënyrën e ndërtimit dhe funksionimit të Qendrës së Përgjimeve, bazën ligjore ku mbështetet ndërtimi i saj, problemet e hasura në praktikë për funksionimin e saj, propozon rrugën e ndryshimeve ligjore për të shmangur ngërçin dhe përplasjen e krijuar midis nenit 23 të ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003, “Për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike”, (i ndryshuar) dhe nenit 223, të Kodit të Procedurës Penale.

❖ **Konkluzion**

Komisioni vlerëson se bazuar dhe në raportin e Grupit të Punës për të tri dokumentet e përzgjedhur nga subjekti për procesin e rivlerësimit, evidentohet se në përgjigjet e përgatitura prej tij, subjekti i rivlerësimit është bazuar në legjislacionin specifik për secilën nga rastet e referuara.

Komisioni nuk vëren problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me vlerësimin profesional.

➤ **Pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura me short**

1. Praktika me nr. *** prot., datë ***** (vendim për refuzimin e kërkesës për zgjatjen e afatit të përgjimit).

Grupi i Punës ka hetuar dhe konstatuar, si më poshtë:

Subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar kërkesën e një institucioni që kryen veprimtari informative, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, për zgjatjen e afatit të lejimit të përgjimit për një subjekt të dyshuar për tendencën e krimeve ndaj jetës së personit.

Pasi ka shqyrtuar kërkesën, subjekti i rivlerësimit ka hartuar “memo”, datë 31.5.2016, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilën sqarohet përmbajtja e kërkesës dhe sugjerohet refuzimi i miratimit të saj. Prokurori i Përgjithshëm, po në atë datë, ka shprehur me shkrim dakordësinë për refuzimin e kërkesës. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka hartuar aktin (vendimin) për refuzimin e

kërkesës me argumentin se kërkesa nuk plotësonte kriteret ligjore të parashikuara në nenet 7 e 14, të ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003, “Për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike”, i ndryshuar.

Kopja e aktit të mosmiratimit të kërkesës, në plotësim të detyrimeve ligjore, të përcaktuara në ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003, i është njoftuar institucionit kërkues, i cili e ka pranuar dhe nuk ka paraqitur ankim kundër aktit.

Në shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës, subjekti i rivlerësimit ka respektuar me rigorozitet kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, i ndryshuar; Vendimi nr. 123, datë 15.3.2001, i Këshillit të Ministrave “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit”, i ndryshuar; Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 290, datë 20.10.2015, “Për listën e dokumenteve të klasifikuara ‘sekret shtetëror’ në prokurori”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni vëren se nga hetimi i praktikës përkatëse rezulton se kërkesa e institucionit që kryen veprimtari informative, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për zgjatje të afatit të lejimit të përgjimit është bërë 1 muaj më vonë se afati ligjor i lejuar. Për rrjedhojë subjekti i rivlerësimit i ka sugjeruar Prokurorit të Përgjithshëm nëpërmjet memos përkatëse, refuzimin e kërkesës.

❖ Konkluzion

Komisioni vlerëson se nga hetimi i kryer rezulton se hetimi, arsyetimi dhe sugjerimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit është i plotë dhe nuk konstatohen problematika.

2. Praktika me nr. *** prot., datë *****, ([REDACTED])

Grupi i Punës ka hetuar dhe konstatuar, si më poshtë:

Subjekti i rivlerësimit, z. Thoma Jano, ka shqyrtuar katër kërkesa të institucionit që kryen veprimtari informative (Ministria e Brendshme), me të cilat i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm lejimin e përgjimit parandalues për katër subjekte të dyshuar për tendenca kriminale të ndryshme.

Pas shqyrtimit të kërkesave, subjekti i rivlerësimit ka hartuar “memo” datë *****, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilën paraqitet në mënyrë të detajuar përmbajtja e tyre, respektimi nga institucioni kërkues i detyrimeve ligjore. Në “memo” subjekti i rivlerësimit ka sugjeruar për mënyrën e zgjidhjes së kërkesave, pranimin e tyre.

Prokurori i Përgjithshëm, po në atë datë, ka shprehur me shkrim dakordësinë për mënyrën e zgjidhjes së kërkesave sipas sugjerimit të bërë nga subjekti i rivlerësimit. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka hartuar aktet përkatëse për secilën prej kërkesave dhe në respektim të neneve 8, 9 e 10, të ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003 ka përpiluar vendimet për lejimin e përgjimit parandalues.

Nga përmbajtja e këtyre akteve “vendim për lejimin e përgjimit”, rezultojnë të strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Vendimet janë ndërtuar sipas standardit të një vendimmarrjeje të kësaj natyre.

Konstatojmë se në shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave, subjekti i rivlerësimit ka respektuar me rigorozitet kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, i ndryshuar; Vendimi nr. 123, datë 15.3.2001, i Këshillit të Ministrave “Për

rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit”, i ndryshuar; Urdhri nr. 290, datë 20.10.2015, i Prokurorit të Përgjithshëm “Për listën e dokumenteve të klasifikuara ‘sekret shtetëror’ në Prokurori”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni vëren se nga hetimi i kryer konstatohet se në lidhje me kërkesën nr. *** prot., datë *****, të Ministrisë së Brendshme për lejim përgjimi për shtetasin ***, është kthyer përgjigje nga Prokurori i Përgjithshëm, firmosur nga prokurori i autorizuar, subjekti i rivlerësimit, për refuzimin e kërkesës, duke dhënë dhe arsyet përkatëse. Subjekti ka përgatitur memon përkatëse në datën *****.

Komisioni ka konstatuar se arsyetimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit në dokumentin “memo”, në lidhje me refuzimin e kërkesës për lejimin e përgjimit, nuk duket i plotë dhe për këtë arsye, me dërgimin e rezultateve të hetimit, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime.

Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, ka shpjeguar, si vijon: *“Institucionet që kryejnë veprimtari informative, në përmbushje të detyrës, bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 9157/2003, kanë të drejtë të kërkojnë edhe përgjimin e komunikimeve elektronike me synim marrjen e të dhënave ndaj subjekteve të dyshuar për kryerjen e veprave penale, që janë në objektin e veprimtarisë së tyre. Referuar nenit 7, germës “ç” të ligjit nr. 9157/2003, institucioni është i detyruar të argumentojë ‘arsyet e përgjimit, si dhe bazën dokumentare ose materialin informativ ku mbështetet kërkesa për përgjim’.*

Në rastin konkret, nga ana e institucionit kërkues në kërkesë janë paraqitur si bazë dokumentare vetëm tri informacione të marra nga burime konfidenciale, të cilat shprehin vetëm dyshime në mënyrë të përgjithshme, jo të detajuara, ndaj subjektit dhe personave të tjerë pa të dhëna konkrete. Institucionet që kryejnë veprimtari informative, përpara se të kërkojnë përgjimin parandalues, janë të detyruara të vërtetojnë informacionet me forma e metoda të tjera, të ligjshme, të kësaj veprimtarie, duke përdorur përgjimin parandalues të komunikimeve elektronike, si rast përjashtimor. Në kërkesë, institucioni kërkues, nuk arsyeton fare se me çfarë forma e metoda të ligjshme ka tentuar të vërtetojë informacionin, për më tepër që informacionet janë marrë nga burime konfidenciale.

Detyrimi, për sa më sipër, buron nga kriteri i përcaktuar në germën “d”, të ligjit nr. 9157/2003, ku thuhet shprehimisht: ‘argumentet që vërtetojnë se përgjimi është i domosdoshëm në situatën e krijuar dhe se të dhënat që kërkohen nuk mund të sigurohen me mjete të tjera’.

Përveç sa më sipër, në kërkesë është pasqyruar edhe çelja e fashikullit të verifikimit, datë 2.4.2015. Në datën 8.4.2015, pra, gjashtë ditë pas çeljes së fashikullit është aplikuar në kërkesën për përgjimin parandalues, çka nënkupton faktin se institucioni në këto gjashtë ditë e ka pasur të pamjaftueshëm aplikimin e formave dhe metodave të tjera të veprimtarisë informative, me synim vërtetimin e dyshimit të ngritur. Përgjimi parandalues nuk mund të përdoret për të lehtësuar punën e institucionit gjurmues, por vetëm pasi plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 9157/2003.

Në praktikën e punës, para marrjes së një vendimi në shqyrtimin e kërkesave, është realizuar edhe konsultë me specialistët që ndjekin gjurmimin informativ. Në rastet kur çmohet e nevojshme, studiohen edhe të dhënat që përmban fashikulli i verifikimit, veprime këto që ndikojnë në mënyrën e vlerësimit të kërkesës. Ndaj këtij vendimi, mospranimi nuk është paraqitur ankesë nga institucioni kërkuar”.

❖ **Konkluzion**

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar dhe argumentuar në mënyrë të qartë dhe konkrete në lidhje me veprimet që duhet të kryheshin nga institucioni përkatës, i cili kërkonte informacionin në lidhje me përgjimin.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimin e bërë, i gjen ato të plota dhe bindëse në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Praktika me nr. *** prot., datë ***** (vendim lejim përgjimi dhe vendim për zgjatjen e afatit të përgjimit).

Grupi i Punës ka hetuar dhe konstatuar, si më poshtë:

Në këtë praktikë përfshihet shqyrtimi nga subjekti i rivlerësimit i tre kërkesave të institucionit, që kryen veprimtari informative. Në një prej këtyre kërkesave, institucioni kërkuar, i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm lejimin e përgjimit parandalues për dy subjekte, ndërsa për dy kërkesat e tjera ka kërkuar zgjatjen e afatit të lejimit të përgjimit.

Pasi ka shqyrtuar kërkesat, subjekti i rivlerësimit ka hartuar “memo”, datë ***** drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të detajuar përmbajtja e tyre, respektimi nga institucioni kërkuar i kërkesave të ligjit.

Në “memo”, subjekti i rivlerësimit ka sugjeruar dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, duke rekomanduar pranimin e kërkesave. Prokurori i Përgjithshëm, po në atë datë, ka shprehur me shkrim dakordësinë për mënyrën e zgjidhjes së kërkesave, sipas sugjerimit të bërë nga subjekti i rivlerësimit.

Në vijim, subjekti i rivlerësimit, në respektim të neneve 8, 9, 10 e 14, të ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003, ka përpiluar aktet përkatëse për secilën prej kërkesave.

Nga përmbajtja e secilit prej akteve “vendim për lejimin e përgjimit” dhe “vendim për zgjatjen e afatit”, rezulton se janë të strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Vendimet janë ndërtuar sipas standardit të një vendimmarrjeje të kësaj natyre. Konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i kuptueshëm dhe i ndarë në paragrafë. Në vendime përmenden dhe analizohen në arsyetim, dispozitat e ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003, “ Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, i ndryshuar, përkatësisht nenet 7,8, 9, 10 dhe 14 dhe konkretisht sipas subjektit të rivlerësimit që kërkesat përmbajnë.

Në vendime, subjekti argumenton se institucioni që ka kërkuar lejimin e përgjimit është i përfshirë në organet që mund të kërkojnë kryerjen e përgjimit sipas pikës 1, nenit 6, të ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003 dhe se kërkesa për lejimin e përgjimit, si dhe për zgjatjen e afatit janë për vepra penale, të cilat janë parashikuar me ligj në objektin e punës e të veprimtarisë informativo-gjurmuese të këtij institucioni.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni vëren se në përpilimin e këtyre akteve, subjekti i rivlerësimit ka respektuar me rigorozitet kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 123 , datë 15.3.2001, “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit”, i ndryshuar; Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 290, datë 20.10.2015, “Për listën e dokumenteve të klasifikuara ‘sekret shtetëror’” në Prokurori”.

❖ Konkluzion

Komisioni vlerëson se nga hetimi i kryer, arsyetimi i bërë nga ana e subjektit të rivlerësimit është i plotë dhe i saktë dhe nuk konstatohen problematika.

4. Praktika me nr. *** prot., datë ***** (vendime për lejim përgjimi dhe vendime për zgjatjen e afatit të përgjimit).

Grupi i Punës ka hetuar dhe konstatuar, si më poshtë:

Kjo praktikë ka të bëjë me shqyrtimin nga subjekti i rivlerësimit, z. Thoma Jano, të 12 (dymbëdhjetë) kërkesave të institucionit, [REDACTED]. Nëpërmjet 3 (tre) kërkesave institucionit kërkues i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm lejin e përgjimit parandalues, ndërsa me 9 (nëntë) të tjerat ka kërkuar zgjatjen e afatit të përgjimit.

Subjekti i rivlerësimit, pasi ka shqyrtuar kërkesat, ka hartuar “memo”, datë 8.1.2015 drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilën përshkruan në mënyrë të detajuar përmbajtjen e kërkesave, respektimin nga institucioni të kërkesave të ligjit dhe në përfundim sugjeron dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Prokurori i Përgjithshëm, po në datën 8.1.2015, ka shprehur me shkrim dakordësinë për mënyrën e zgjidhjes së kërkesave sipas sugjerimit të bërë nga subjekti i rivlerësimit. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, në respektim të neneve 8 , 9 , 10 dhe 14, të ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003, ka hartuar aktet përkatëse (vendimet) për secilën prej kërkesave, tri vendime për lejin e përgjimit parandalues dhe nëntë vendime për zgjatjen e afatit të përgjimit.

Konstatojmë se në shqyrtimin e këtyre kërkesave, subjekti i rivlerësimit ka respektuar kriteret dhe kushtet e parashikuara në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, i ndryshuar; Vendimin nr. 123 , datë 15.3.2001, të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit”, i ndryshuar; Urdhrin nr. 290 , datë 20.10.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për listën e dokumenteve të klasifikuara ‘sekret shtetëror’” në Prokurori”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni vëren se nga hetimi i kryer, praktika nr. *** ka në përbërje të saj dhe kërkesën nr. ***, datë *****, për të cilën është kthyer përgjigje për refuzim të lejit të përgjimit. Subjekti ka përgatitur dokumentin përkatës në lidhje me arsyet e këtij refuzimi.

Komisioni ka konstatuar se arsyetimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me refuzimin e kërkesës për lejimin e përgjimit, nuk është i plotë dhe për këtë qëllim, me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime.

Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar në lidhje me konstatimin, si vijon: *“Të dhënat në bazën dokumentare lidhur me dyshimin e ngritur ndaj subjektit burojnë nga rezultatet e interceptimit ndaj një subjekti tjetër, i dyshuar për të njëjtën tendencë.*

Nga studimi i të dhënave të interceptimit rezulton se pas datës 15 korrik 2014 nuk janë përfituar të dhëna në interes të dyshimit të ngritur, ndërkohë që kërkesa është bërë në datën 6.1.2015, pra, pas pesë muaj e gjysmë. Mungesa e të dhënave për një periudhë të gjatë kohe vlerësohet si një ndërprerje e aktivitetit të dyshuar (e përkohshme, e përhershme; subjekti mund të jetë arrestuar; mund të jetë duke kaluar sëmundje të rëndë; apo për shkaqe të tjera objektive e subjektive) e, për rrjedhojë, të dhënat nuk mund të vlerësohen në kohe reale. Përveç të dhënave të përfituara nga interceptimi, nuk rezulton që institucioni kërkues të ketë tentuar të marrë të dhëna në aplikim të formave e metodave të tjera të ligjshme, të parashikuara në nenin 6, të ligjit nr. 8391/1998, ‘Për Shërbimin Informativ Shtetëror’. Sipas dispozitës më sipër, institucioni ligjzbatues (në rastin konkret SHISH) e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me procedurat e hartuara nga kryetari dhe të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë. Prokurori i Përgjithshëm ka të drejtë të ushtrojë kontroll mbi zbatimin e këtyre procedurave. Këto procedura përcaktojnë ndër të tjera:

ç) rrugët për verifikimin dhe vërtetimin e burimeve të informacionit

Në rastin më sipër nuk rezulton të jenë aplikuar forma e metoda të tjera të ligjshme të kësaj veprimtarie, me synim vërtetimin e informacionit. Detyrimi më sipër, buron nga kriteri i përcaktuar në germën ‘d’, të ligjit nr. 9157/2003, ku thuhet shprehimisht: ‘argumentet që vërtetojnë se përgjimi është i domosdoshëm në situatën e krijuar dhe se të dhënat që kërkohen nuk mund të sigurohen me mjete të tjera’.

Referuar kësaj dispozite sqaroj se SHISH-i e kishte mundësinë e marrjes së informacionit, pasi kishte nën përgjim parandalues një subjekt.

Në ndryshim nga Policia e Shtetit, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje (në varësi të Ministrisë së Drejtësisë) Shërbimi Informativ i Shtetit nuk kryen veprimtari të karakterit ushtarak ose policor. Kur krijon bindjen për një shkelje të ligjit, informon në institucionin përkatës, duke mbrojtur burimet dhe metodat informative(neni 9, i ligjit nr. 8391/1998).

Në nenin 13, paragrafi i dytë i ligjit nr. 8391/1998 shprehet: ‘SHISH bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore në zbatim të këtij ligji, duke u dhënë informacion deri në atë masë, që lejon mbrojtja e burimeve dhe e metodave të punës’.

Duke bërë interpretimin e dy dispozitave më sipër theksoj se Shërbimi Informativ ka detyrimin të vërtetojë informacionin lidhur me përfshirjen e një subjekti në një veprimtari të kundërligjshme dhe nëse krijon bindje mbi vërtetësinë e tij, e përcjell informacionin në institucionin përkatës, në rastin konkret Policisë së Shtetit, e cila ka struktura me atributet e policisë gjyqësore, gjë të cilën ligji nuk ia ka lejuar Shërbimit Informativ. Këmbimi i informacionit është dhe një detyrim që rrjedh

nga ligji nr. 8750 , datë 26.3.2001, “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike e psikotrope”.

❖ **Konkluzion**

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar mbi arsyet e refuzimit të kërkesës për përgjim, gjithashtu, arsyeton se nga institucioni, i cili ka kërkuar përgjimin në mungesë të informacionit për periudhën e sipërcituar, nuk rezulton të jenë aplikuar metoda të tjera të parashikuara në ligj për vërtetimin e informacionit për të ligjëruar kërkesën e tij për vijimin e përgjimit.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë të plota dhe bindëse dhe në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë çështje.

5. Praktika me nr. *** prot., datë ***** (vendime për zgjatjen e afatit të përgjimit).

Kjo praktikë ka të bëjë me shqyrtimin nga subjekti i rivlerësimit, z. Thoma Jano, të 11 (njëmbëdhjetë) kërkesave të institucionit [REDACTED]. Nëpërmjet tyre, institucioni kërkues i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm, zgjatjen e afatit të përgjimit.

Subjekti i rivlerësimit, pasi ka shqyrtuar kërkesat ka hartuar “memo”, datë 19.9.2014, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilën përshkruhet në mënyrë të detajuar përmbajtja e kërkesave, përmbushja nga institucioni kërkues i detyrimeve ligjore, duke sugjeruar edhe mënyrën e zgjidhjes së tyre. Prokurori i Përgjithshëm, po në datën 19.9.2014, ka miratuar mënyrën e zgjidhjes së kërkesave të sugjeruara nga subjekti i rivlerësimit. Pas kësaj, subjekti i rivlerësimit, në respektim të nenit 14, të ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003, ka përpiluar aktet (vendimet) përkatëse për secilën prej kërkesave.

Subjekti argumenton se kërkesat për zgjatjen e afatit të lejimit të përgjimit janë në përshtatje me kriteret e përcaktuara në nenin 14, të ligjit nr. 9157 , datë 4.12.2003. Sipas kësaj dispozite për çdo zgjatje të afatit të përgjimit, institucioni shtetëror informativ i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm një kërkesë, së bashku me materialin e deriatëhershëm të zbardhur. Çdo zgjatje afati nuk mund të jetë më tepër se tre muaj.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Në shqyrtimin e kërkesave, subjekti i rivlerësimit ka respektuar me rigorozitet kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’” i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 123 , datë 15.3.2001, “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit” i ndryshuar; Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 290, datë 20.10.2015, “Për listën e dokumenteve të klasifikuara ‘sekret shtetëror’” në Prokurori”.

❖ **Konkluzion**

Komisioni vlerëson se nga hetimi i kryer, arsyetimi i bërë nga subjekti është i mjaftueshëm, i plotë dhe nuk konstatohen problematika.

Konstatime të Komisionit në lidhje me afatet procedurale

Komisioni, nga verifikimi i pesë dokumenteve ligjore të mësipërme, në disa raste ka konstatuar se pavarësisht se kërkesat e institucioneve që kryejnë veprimtari informative janë bërë në tejkallim të afatit 5-ditor (brenda afatit 3-mujor), përsëri nga subjekti është proceduar me vendimmarrje për miratim të zgjatjes së afatit të lejes së përgjimit. Për këtë qëllim, me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit i janë kërkuar shpjegime.

Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, ka shpjeguar se:

“Në nenin 14 të ligjit nr. 9157/2003, për përgjimin parandalues: ‘Kohëzgjatja e vendimit të përgjimit’, përveç kohëzgjatjes së vendimit të përgjimit, nuk ishin parashikuar afate të paraqitjes së kërkesave dhe as se sa afat kohor i lihej Prokurorit të Përgjithshëm deri në shqyrtimin e kërkesës. Neni 14:

1. Të gjitha vendimet e përgjimit janë të vlefshme për një periudhë deri në tre muaj. Për çdo zgjatje të këtij afati, institucioni shtetëror informativ i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm një kërkesë së bashku me materialin e deriatëhershëm të zbardhur.

2. Çdo zgjatje afati nuk mund të jetë më tepër se tre muaj.

Në Udhëzimin e përbashkët ishte parashikuar që kërkesat për zgjatje të afatit t’i paraqiteshin Prokurorit të Përgjithshëm pesë ditë para përfundimit të afatit. Ky udhëzim, përveç të tjerave, synonte disiplinimin e punës brenda institucionit, si dhe në marrëdhënien mes institucioneve, por ai nuk parashikon një vendimmarrje ndryshe, e ndikuar nga paraqitja me vonesë e një kërkesë.

Në datën 7.6.2017 ka hyrë në fuqi ligji nr. 69/2017, ‘Për disa ndryshme dhe shtesa në ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003, ‘Për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike’, i ndryshuar.

Në nenin 8, të ligjit të ndryshuar ‘Dhënia e së drejtës për përgjim’, paragrafi i dytë është përcaktuar afat vetëm për shqyrtimin e kërkesave për lejimin e përgjimit ,brenda 48 orëve nga momenti i paraqitjes së tyre, ndërsa për rastet e zgjatjes së afatit (neni 14) ligji nuk përcakton afat as për paraqitjen e tyre nga institucioni kërkues te autoriteti vendimmarrës dhe as afat për shqyrtimin e saj. Kërkesat për lejimin e përgjimit, sidomos ato për zgjatjen e afatit, kërkojnë kohë për studimin dhe verifikimin e të dhënave deri në marrjen e vendimit. Është kjo arsyeja pse ligjvënësi, në ndryshimet ligjore (ligji nr. 69/2017) i ka dhënë të drejtën autoritetit vendimmarrës të kërkojë shpjegime ose arsye shtesë për zgjatjen e afatit nga institucioni kërkues”.

❖ Konkluzion

Komisioni vëren se subjekti, në shpjegimet e tij, ka argumentuar se afatet procedurale të kthimit të përgjigjes nga institucioni kërkues, i cili ka dërguar kërkesën për zgjatje afati përgjimi, i nënshtrohen ligjit specifik të sipërcituar, që nuk përcakton afat as për paraqitjen e këtyre kërkesave dhe as afat për shqyrtimin e tyre, prandaj dhe autoriteti vendimmarrës për pranimin ose jo të këtyre kërkesave (për zgjatje afat përgjimi) ka të drejtën sipas ligjit të kërkojë shpjegime dhe arsye shtesë për zgjatje afati nga institucioni kërkues.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë të plota dhe të bazuara në ligjet përkatëse dhe në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë çështje.

➤ **Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore – vlerësimet)**

Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe informacionet e ardhura nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore nuk rezultojnë që subjekti Thoma Jano të ketë pasur masa disiplinore apo të jenë depozituar ankesa lidhur me punën e kryer. Gjithashtu, ndaj subjektit nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

➤ **Denoncimet nga publiku**

Për subjektin e rivlerësimit, z. Thoma Jano, është depozituar një denoncim i shtetasës E.S., me nr. *** prot., datë 22.8.2018.

Shtetasja E.S. ngre ankesa ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Thoma Jano, (për një çështje penale të vitit 2000), pasi subjekti së bashku me një prokuror tjetër ka bërë një hetim të njëanshëm dhe të pamoralshëm, provat dhe argumentet e dosjes u anashkaluan dhe u zhdukën. Si rezultat i këtij hetimi, autori i vrasjes bëri vetëm 6 muaj burg dhe si rezultat i zhdukjes së provave u shpall i pafajshëm dhe u shpërblye me 10.5 milionë lekë për ditët e qëndrimit në burg.

❖ **Konkluzion**

Komisioni konstaton se ky denoncim bën fjalë për një çështje penale të vitit 2000, që rezultojnë të jetë jashtë periudhës 3-vjeçare të vlerësimit nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sikurse parashikohet në pikën 3, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, gjithashtu, rezultojnë të jetë dhe jashtë afatit nga data 1.1.2006 e në vazhdim, periudhë e përcaktuar nga pika 4, e nenit 41 të po këtij ligji, dhe për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se ky denoncim nuk mund të shqyrtohet nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit.

❖ **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

Trupi gjykues vlerëson se në vlerësim të të gjitha rrethanave dhe të kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme, shfaq aftësi në arsyetimin ligjor, respekton standardin e procesit të rregullt ligjor dhe konsiderohet “i aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka përmbushur kushtet ligjore të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 1/a, të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Thoma Jano.
2. Vendimi i arsyetuar i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose nga Komisioneri Publik brenda 15 ditëve, nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 17.2.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Olsida Goxhaj
Sekretare gjyqësore